



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Strategjia e BE-së dhe palëve të tjera të interesit në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Dokument Politikash
12 janar 2021

Autore: Leonie Vrugtman



This project has received funding from the European Union's Horizon 2020 research and innovation programme under grant agreement no 870724. Unless otherwise indicated, the views expressed are attributable only to the authors in a personal capacity and not to any institution with which they are associated, nor do they necessarily reflect the views or policy of the European Commission. For more information on the PREVEX project, see <http://www.prevex-balkan-mena.eu>.

Lista e shkurtimeve

KiE	-	Këshilli i Evropës
Qendra CVE	-	Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm - Shqipëri
OSHC	-	Organizatë e Shoqërisë Civile
QQSSG	-	Qendra për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë në Gjenevë
XIE	-	Xihadi Islamik Egjiptian
BE	-	Bashkimi Evropian
LH	-	Luftëtar i Huaj / Luftëtar i Huaj Terrorist
FKBAQ	-	Fondi i Komunitetit Botëror për Angazhim dhe Qëndresë
IDM	-	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
ONM	-	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KMSH	-	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
KVSP	-	Këshilli Vendor për Sigurinë Publike
OSBE	-	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
P/LKEDH	-	Parandalimi / dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm
PREVEX	-	Projekti për “Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkan dhe Forcimi i Qëndrueshmërisë në Mjedise Mundësuese
LMAV	-	Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore
RNR	-	Rrjeti i Ndërgjegjësimit ndaj Radikalizimit
KBR	-	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
LHT/R	-	Luftëtar i Huaj Terrorist/ I rikthyer
R&R	-	Rehabilitimi dhe Riintegrimi
SHQK	-	Shkolla Qendër Komunitare
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PNUD	-	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
USAID	-	Agjencia Amerikane për Zhvillimin Ndërkombëtar
EDH	-	Ekstremizmi i Dhunshëm
DERPT	-	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi që çon në terrorizëm



Përmbajtja

<i>Lista e shkurtimeve</i>	1
<i>Hyrje</i>	3
<i>Mjedisi në vend</i>	5
Shqiptarët që udhëtuan në Irak dhe Siri	7
Përfshirja e KMSH-së në P/LKEDH	8
Shkaqet rrënjësore të EDh (Islamik)	9
Format e tjera të Ekstremizmit të Dhunshëm	10
<i>Anti-Terrorizmi dhe Strategjitë P/LKEDH në Shqipërisë</i>	12
Anti-Terrori në Shqipëri pas vitit 2011	12
P/LKEDH në Shqipëri	13
Zbatimi i Strategjisë LKEDH: angazhimi i OSHC-ve në P/LKEDH	14
<i>Strategjia P/LKEDH e BE-së në Shqipëri</i>	17
Marrëveshja dypalëshe Kundër Terrorizmit	18
<i>Nisma të OSHC-ve të financuara nga BE-ja</i>	21
Rritja e kapaciteteve të OSHC-ve	21
Projektet kryesore të OSHC-ve në Shqipëri	23
Të rikthyerit.....	24
<i>Qasja e SHBA-ve për të mbështetur P/LKEDH në Shqipëri</i>	27
<i>Krahasimi i strategjive dhe nismave të jashtme P/LKEDH</i>	29
<i>Perspektiva e aktorëve vendor mbi strategjitë e huaja P/LKEDH</i>	31
<i>Konkluzion</i>	34
Rekomandime	35
Kufizimet	36



Kanë kaluar më shumë se pesë vjet që kur 1353¹ burra, gra dhe fëmijë nga Ballkani Perëndimor shkuan në Irak dhe Siri. Që atëherë, qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë masa të theksuara për të dënuar ata që kanë udhëtuar për t'iu bashkuar një grupi të huaj (para)ushtarak dhe për të dekurajuar të tjerë që të mos ndjekin hapat e tyre. Në vitin 2014 dhe 2015, qeveritë e këtyre vendeve ndryshuan kodet penale dhe e kriminalizuan bashkimin me operacione ushtarake jashtë vendit, dhe mbështetjen e operacioneve ushtarake jashtë vendit në mënyra të tjera (si nxitja e të tjerëve që t'u bashkohen këtyre grupeve, ofrimi i ndihmës që t'i bashkohen, ose duke u ofruar mbështetje financiare)². Pjesa dërmuese e vendeve ndoqën hapat e tyre duke hartuar dhe miratuar Strategji Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me anë të së cilave parashtrohen një sërë masash dhe veprimesh për t'u ndërmarrë nga palët e interesit, përfshi qeverinë qendrore dhe sektorin publik të arsimit, zbatimit të ligjit dhe mirëqenien sociale.

Organizatat e shoqërisë civile – me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar dhe donatorëve të huaj – janë përfshirë në rritjen e njohurive mbi fenomenin dhe në zbatimin e projekteve për të parandaluar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në të ardhmen. Përveç Departamentit Amerikan të Shtetit dhe PNUD, Bashkimi Evropian dhe vendet anëtare janë donatorët kryesorë të projekteve që synojnë të luftojnë dhe parandalojnë ekstremizmin e dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. Afërsia fizike e rajonit, numri i lartë i luftëtarëve të huaj në raport me popullsinë, dhe historiku i paqëndrueshmërisë, kanë nxitur shqetësimin e BE-së dhe vendeve anëtare. Për më tepër që, luftëtarët e huaj nga vendet e BE-së dhe vendet fqinje kanë bashkëvepruar në kryerjen e disa sulmeve të mëdha, përfshi sulmin e Parisit në vitin 2015; në Bruksel, Berlin dhe Nisë në vitin 2016; dhe në Mançester, Londër dhe Barcelonë në vitin 2017.

Që nga viti 2001, BE-ja ka zhvilluar dhe përmirësuar disa herë qasjet dhe politikat e saj kundër terrorizmit. Sidoqoftë, sfidat në rritje si fenomeni i rikthimit të luftëtarëve të huaj, ndërkohë që problematikat strukturore, shoqërore dhe ekonomike nuk janë zgjidhur akoma, e bëjnë të domosdoshëm hartimin e qasjeve më të mira dhe efektive për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm – si brenda BE-së ashtu edhe me fqinjët e saj. Prandaj, projekti “Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkan dhe LMAV: Forcimi i Qëndrueshmërisë në Mjedise

¹ Joana Cook dhe Gina Vale, “Nga Daeshi në ‘Diasporë’ II: Sfidat që Shfaqin Gratë dhe Minorenët Pas Rënies së Kalifatit,” CTC Sentinel, Vol. 12, No. 6 (korrik 2019), faqe. 30-45. Shkëputur nga:

<https://ctc.usma.edu/daeshdiaspora-challenges-posed-women-minors-fall-caliphate/>

² Pas miratimit të rezolutës 2179 (2014) të Këshillit të Sigurisë në OKB, Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë ndryshuar kodin penal në të njëjtin vit, ndërsa Kosova dhe Mali i Zi në vitin 2015.



Mundësuese” (PREVEX) ka kryer studime të rrethanave me ndjeshmëri, dhe një studim të detajuar mbi shfaqjen apo mungesën e ekstremizmit të dhunshëm. Këto studime të thelluara, të cilat do të bashkëlidhen si krahasime rajonale, ndihmojnë në rritjen e njohurive sesi faktorët nxitës të ekstremizmit të dhunshëm operojnë, dhe çfarë mund të bëhet për të forcuar qëndresën në “mjediset mundësuese”.

Gjetjet e këtij studimi kontribuojnë në hartimin e politikave më efektive që parandalojnë ekstremizmin e dhunshëm nëpërmjet forcimit të qëndresës shoqërore ndaj fenomenit. PREVEX ndjek qasjen nga poshtë-lart të dinamikave në rang lokal dhe botëror, e cila nënkupton se ky studim është i pari mes disa dokumenteve të tjerë politikash specifike që kontribuon në analizat e vendeve shqip-folëse dhe analizat e mëtejshme rajonale në Ballkan. Ky dokument politikash përqendrohet në aftësinë e strategjisë së BE-së dhe palëve të tjera të interesit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Së pari, ky studim do të shpalosë gjendjen aktuale të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm (DERPT) në Shqipëri. Më pas, studimi ofron një përshkrim të strategjive të brendshme dhe të jashtme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (P/LKEDH), si dhe veprimeve të zbatuara në vend. Kjo pasohet me një analizë të përshtatshmërisë së këtyre nismave bazuar në racionalitetin e tyre dhe “shkaqet kryesore” për DERPT në Shqipëri. Së fundmi, ky studim ofron një sërë rekomandimesh që do ndihmonin në përmirësimin e nismave të jashtme P/LKEDH të zbatuara në Shqipëri.



Mjedisi në vend

Nga viti 1944 deri në vitin 1991, Shqipëria është udhëhequr nga një regjim komunist, në të cilin që nga viti 1967 janë persekutuar udhëheqësit fetar dhe shfaqja e simboleve fetare ka qenë e ndaluar me ligj. Megjithëse kanë kaluar gati 30 vite që kur është rifituar liria fetare, pjesa dërrmuese e shqiptarëve jetojnë jetë jofetare. Sipas një studimi mbi tolerancën fetare të vitit 2018, “Shqiptarët e mirëpresin diversitetin fetar që është i pranishëm në vend dhe e kundërshtojnë me forcë idenë e epërsisë së një feje të caktuar ndaj të tjerave, pavarësisht nga madhësia e komunitetit përkatës fetar.”³. Bashkëjetesa fetare dhe toleranca cilësohen si vlera thelbësore dhe qytetarët shqiptarë rrallëherë janë të kufizuar nga normat fetare në jetën e përditshme. Sipas censusit të fundit zyrtar të mbajtur në vitin 2011⁴, Myslimanët Suni përbëjnë 56.7% të popullsisë, Katolikët 10%, Ortodoksët 6.8%; Bektashijntë (një sekt i Sufizmit Shia) 2.1%; dhe komuniteti i Ungjillorëve Protestant 0.4%. Afërsisht 2.5% e qytetarëve shqiptarë identifikohen si ateistë. Ka edhe komunitete të vogla të Dëshmitarëve të Jehovait, Ndjekës të Kishës së Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (Mormon), përveç kësaj janë edhe 40 deri në 50 Hebrenj që jetojnë në Shqipëri.⁵

Për shkak të ndalimit të fesë për dekada me radhë, institucionet fetare në vend ishin në një gjendje shumë të rëndë. Fondacionet e huaja nxituan të vinin në Shqipëri për të rigjeneruar besimin, edukuar një gjeneratë të re klerikësh, dhe për të rindërtuar objektet fetare. Në mesin e viteve 1990, një sërë misionesh fetare, përfaqësues të degëve të ndryshme të Islamit dhe Krishtërimin mbërritën në Shqipëri. Mijëra të rinj Mysliman Suni shkuan në Turqi, vende të Lindjes së Mesme dhe Azi, dhe u kthyen pastaj në Shqipëri pasi përqaftuan mes të tjerash edhe forma të ndryshme të shkollës së Uahabizmit dhe Salafizmit në vend të shkollës Hanafi që ndiqet tradicionalisht në Shqipëri⁶. Shumë prej organizatave trajnuan klerikët aspirues, të cilët do predikonin në një nga xhamitë e reja (të peregjistruara) me tu rikthyer në vendlindje⁷. Synimi i këtyre fondacioneve fetare – që shpesh ishin të lidhura me qeveri të vendeve të huaja – nuk ishte vetëm rindërtimi i Komunitetit Mysliman Shqiptar, por edhe ushtrimi i ndikimit në jetën fetare

³ Vurmo, G., Sulstarova, E. & Papa, A. (2017). Toleranca fetare në Shqipëri. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, faqe. 5, i disponueshëm në: <http://idmalbania.org/religious-tolerance-albania/>

⁴ Përfaqësuesit e gjithë komuniteteve fetare janë shprehur që census i vitit 2011-të nuk pasqyron demografinë reale të besimit fetar, për më tepër që ishte edhe pyetje me zgjedhje. Censusi është i disponueshëm në shqip dhe anglisht: http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf

⁵ Kongresi Botëror i Hebrenjëve. (pa datë.). Shqipëria (Raport). Shkëputur nga: <http://www.worldjewishcongress.org/en/about/communities/AL>

⁶ Vickers, M. (2008). Islami në Shqipëri. Kërkim i Avancuar i Grupit të Vlerësimit. Seria e Ballkanit 08/09. Akademia e Mbrotjes së Mbretërisë së Bashkuar.

⁷ Intervistë me zyrtar të KMSH-së. 11 nëntor 2020.



dhe politike të vendit⁸. Sipas një zyrtari të Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH), persona të caktuar janë kompensuar financiarisht për të përhapur në Shqipëri interpretimin fetar të fituar gjatë studimeve jashtë vendit⁹.

Në vetvete, ringjallja e besimit në Shqipëri ishte një sipërmarrje fisnike dhe e nevojshme, por për shkak të dobësisë së institucioneve shtetërore, kontrollit të dobët kufitar, dhe nivelin e lartë të krimit, terroristët arritët të krijonin terrenin e tyre në Shqipëri. Ka pretendime sipas të cilave, vetë Osama Bin Laden ka urdhëruar krijimin e disa shoqatave fetare bamirësie në Shqipëri si maskim për aktivitetet terroriste që po mbaheshin¹⁰. Sipas këtyre pretendimeve, ai vetë ka vizituar Shqipërinë në vitin 1994 dhe 1998, i maskuar si një biznesmen i pasur i cili donte të ndihmonte një vend mysliman nëpërmjet “ndihmave humanitare”¹¹. Në vitin 1998, operativë të CIA-s së bashku me autoritetet shqiptare kanë koordinuar një fushatë për shkatërrimin dhe arrestimin e bashkëpunëtorëve të celulës së Xhihadit Islamik Egjiptian (XIE) në Shqipëri^{12,13,14}. Mes anëtarëve të saj – gjatë një gjyqi në Egjipt, i cilësuar si “Të Rikthyerit nga Shqipëria” – ishte edhe Mohammad al-Zawahiri, vëllai i vogël i udhëheqësit të al-Kaedas Ayman al-Zawahiri^{15,16}.

Pas këtij arrestimi dhe sulmeve të 11 shtatorit dy vite e gjysmë më vonë, qeveria e Shqipërisë mori masa për të dëbuar terroristë të dyshuar dhe për të trajtuar problemin e grupeve fetare të mbështetura nga jashtë. Një plan kombëtar kundër terrorizmit i miratuar në vitin 2002, çoi në zbatimin gjithëpërfshirës të masave, përfshi edhe bllokimin e aseteve financiare dhe jo vetëm të personave dhe grupeve të dyshuar për lidhje me terroristë¹⁷. Gjithashtu, për të ndihmuar me rindërtimin e komuniteteve fetare, qeveria premtoi kompensim për ndërtesat fetare, tokat dhe pronat e konfiskuara nga regjimi komunist. Megjithatë, mbeten të pazgjidhura; problem i xhamive që operojnë jashtë kontrollit të KMSH-së, Imamët që predikojnë versione të importuara

⁸ Deliso, C. (2007). Kalifati i Ardhshëm i Ballkanit: Kërcënimi i Islamit Radikal për Europën dhe Perëndimin. Faqe.31-32. Westport, CT: Praeger Security International

⁹ Intervistë me zyrtar të KMSH-së. 11 nëntor 2020.

¹⁰ Deliso, C. (2007). Kalifati i Ardhshëm i Ballkanit: Kërcënimi i Islamit Radikal për Evropën dhe Perëndimin. Faqe. 31-32. Westport, CT: Praeger Security International

¹¹ Ibid.

¹² Departamenti Amerikan i Shtetit (1998). Modele të terrorizmit global 1998: Përmbledhje e Europës. Shkëputur nga: <https://1997-2001.state.gov/global/terrorism/1998Report/europe.html#albania>

¹³ Higgins, A., & Cooper, C. (2001, Nëntor 19). Një skuadër e mbështetur nga CIA ka përdorur metoda të dhunshme për të shkatërruar një celulë terroriste në Shqipëri. Free Republic. Shkëputur nga: <http://www.freerepublic.com/focus/f-news/574520/posts>

¹⁴ Komiteti Kombëtar mbi Sulmet Terroriste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. (2004). Raporti i Komisionit për 9/11. Faqe. 127. Shkëputur nga: <https://www.9-11commission.gov/report/911Report.pdf>

¹⁵ Deliso, C. (2007). Kalifati i Ardhshëm i Ballkanit: Kërcënimi i Islamit Radikal për Evropën dhe Perëndimin. Faqe. 31-32. Westport, CT: Praeger Security International

¹⁶ Ka zëra të pakonfirmuar se al-Zawahiri ka vdekur në vjeshtën e 2020-ës nga shkaqe natyrore.

¹⁷ S. Woehrel, ‘Terrorizmi Islamik në Ballkan’, Shërbimi i Kërkimeve në Kongres, 26 korrik 2005, faqe. 7



të Islamit, dhe ardhja e fondeve nga Turqia dhe vendet e Gjirit për të ushtruar ndikim fetar dhe politik.

Shqiptarët që udhëtuan në Irak dhe Siri

Sidoqoftë, ishte shumë befasues lajmi që mes viteve 2012 dhe 2015, rreth 144 qytetarë shqiptarë u larguan për t'iu bashkuar grupeve rebele në Irak dhe Siri¹⁸. Shumica e shqiptarëve të rikthyer, u kthyen brenda pak muajsh pas largimit. E gjitha kjo ndodhi përpara se të vetë-shpallej i ashtuquajti Kalifat në Siri dhe Levant; si dhe para se ndryshimet në kodin penal të Shqipërisë të hynin në fuqi, të cilat e kriminalizuan pjesëmarrjen në konflikte jashtë vendit. Mendohet gjerësisht se 28 shtetas shqiptarë kanë vdekur, ndërsa 81 të tjerë mbeten akoma në Siri¹⁹. Megjithëse numri i udhëtarëve në bazë të popullsisë ishte më i vogël nga Shqipëria krahasuar me vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor, konteksti në të cilin shtetasit e saj u larguan dëshmon se Shqipëria po përballej me një sfidë madhore sigurie. Ndryshe nga shtetet e tjera (Evropiane), një pjesë e madhe e grupit të larguar përbëhej nga familje të tëra, ku gratë dhe fëmijët udhëtuan bashkarisht me bashkëshortët dhe baballarët e tyre²⁰. 27 gra, 38 minorenë, dhe 79 burra u bashkuan përpjekjeve kundër Bashar al-Assad²¹ – të cilëve, sipas raportimeve mediatike, ju shtuan edhe 13 fëmijë të lindur në teatrin e luftës²². Familjet e larguara, udhëtuan në grupe dhe vinin kryesisht nga të ashtuquajtura pika të nxehta, të cilat ishin më të ndikuara nga radikalizmi²³.

Këto komunitete përfshijnë periferinë e Tiranës (Mëzes dhe Unaza e Re), disa zona përreth Elbasanit (Cërrik dhe Peqin), si dhe bashkitë e Librazhdit, Bulqizës, Kukësit dhe Pogradecit²⁴. Shumë prej udhëtarëve kishin shkuar në xhamitë e ashtuquajtura të “paligjshme” në Mëzes dhe Unazën e Re, të cilat administroheshin nga imamë të vetëshpallur apo nga individë të tjerë që kishin kontakte me këta të fundit. Ky grup, dhe rrjeti i tyre i rekrutimit, i përbërë nga nëntë

¹⁸ Komisioni Evropian. (2018). Progresi Raporti për Shqipërinë 2018. Faqe. 36. Shkëputur nga:

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

¹⁹ Komisioni Evropian. (2020). Progresi Raporti për Shqipërinë 2020. Shkëputur nga:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

²⁰ Joana Cook dhe Gina Vale, “Nga Daeshi në ‘Diasporë’ II: Sfidat që Shfaqin Gratë dhe Minorenët Pas Rënies së Kalifatit,” CTC Sentinel, Vol. 12, No. 6 (korrik 2019), pp. 30-45. Shkëputur nga::

<https://ctc.usma.edu/daeshdiaspora-challenges-posed-women-minors-fall-caliphate/>, Shkëputur nga: 12 Tetor 2020

²¹ GCERF. (2020). GCERF Strategjia Rajonale për Investim në Ballkanin Perëndimor. Shkëputur nga:

<https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.pdf>

²² Mejdini, F. (2019). Familjet Shqiptare të Luftëtarëve të ISIS Kanë Përpara një Rrugë të Gjatë për Riatdhesim.

Balkan Insight. Shkëputur nga: <https://balkaninsight.com/2019/04/18/families-of-albanian-isis-fighters-face-long-road-home/>

²³ Për më shumë të dhëna lidhur me zonat më të ndikuara nga Edh, referohuni raportit “Ekstremizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri (Vurmo, 2015)

²⁴ Pjesa më e madhe e emrave (përfshi. vendbanimin) të LHT janë regjistruar nga kërkuesit e IDM-së.



persona, cilësohen si përgjegjës për rekrutimin e suksesshëm të 70 personave të cilët kanë udhëtuar drejt Irakut dhe Sirisë²⁵. Sipas Kryetarit të Komunitetit të Kulteve, z. Ilir Dizdari, në vitin 2015, rreth 200 nga 727 xhamitë e vendit, nuk përmbushnin “të paktën një nga kriteret ligjore të Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH)”²⁶. Që atëherë, KMSH e ka bërë prioritet që të marrë nën mbikëqyrjen e saj ligjore të gjitha xhamitë e vendit, të përgatisë imamët, dhe të sigurojë përgatitjen e brezit të ardhshëm të imamëve me arsim fetar të akredituar në Shqipëri²⁷.

Përfshirja e KMSH-së në P/LKEDH

E vetëdijshme se Shqipërisë i mungonte një institute arsimor për Shkencat Islame, KMSH themeloi universitetin fetar “Bedër” në vitin 2011²⁸. Mes programeve të ofruara, si juridiku dhe gjuhët e huaja, Universiteti Beder ofron diploma të nivelit bachelor dhe Master në Shkencat Islame²⁹, gjë që efektivisht kompletonte ciklin arsimor fetar pas hapjes së medreseve në vitin 1991. Për të unifikuar mesazhin e predikuar nga Imamët në Shqipëri, dhe për të përshtatur predikimin me nevojat e besimtarëve shqiptarë, KMSH ka organizuar disa kurse trajnimi për Imam³⁰. Bashkë me imamët që më përpara predikonin në xhamitë e pakontrolluara nga KMSH, janë trajnuar edhe studentë që kërkonin të përmbyllnin programin akademik. Që nga zbatimi i aktivitetit të parë të lidhur me P/LKEDH në vitin 2014, KMSH-ja ka qenë më e hapur për bashkëpunim si me autoritetet ashtu edhe me shoqërinë civile. Për më tepër, ka lëshuar urdhra për Imam dhe ka mbajtur diskutime të brendshme të organizuara për të nxitur dialog mes Imamëve të angazhuar në strukturat e KMSH-së, shoqërinë civile, qeverinë vendore, dhe shkolla, me fokus të veçantë projektet që lidhen me parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm të nxitur nga feja³¹. Së bashku me ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, KMSH-ja ka zbatuar projektin “Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm” për pesë vite, i cili synon të promovojë vlerat demokratike, bashkëjetesën, dhe harmoni mes të rinjve shqiptarë³².

²⁵ Çobo, S. (26 February 2016). Imamët rekrutuan edhe Nëna me Fëmijë 70 veta janë dërguar në Siri. Nga Gazeta Shqip: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2015/02/26/imamet-rekrutuan-edhe-nena-mefemije-derguan-ne-siri-70-luftetare/> Vizituar më 14 tetor 2020.

²⁶ Mejdini, F. (17 dhjetor 2015). Shtohen Xhamitë e Pakontrolluara në Shqipëri. BIRN. Shkëputur nga: <https://balkaninsight.com/2015/12/17/state-slams-albanian-muslim-over-uncontrolled-mosques-12-17-2015/>

²⁷ Intervistë me zyrtar të KMSH-së, 11 Nëntor 2020.

²⁸ *Ibid.*

²⁹ Bedër University. (2020). Të dhëna të përgjithshme. Shkëputur nga: <https://www.beder.edu.al/en/content/default/general-information-9-10/4/135>

³⁰ Intervistë me zyrtar të KMSH-së, 11 Nëntor 2020.

³¹ IDM ka bashkëpunuar ngushtë me KMSH-në në disa kërkime studimi, për rritjen e ndërgjegjësimit, trajnimeve, dhe për momentin po punojnë bashkë në një nismë SHQK.

³² Për më shumë lidhur me projektin, shih: <https://kmsH.al/2019/11/angazhimi-i-te-rinjve-per-ndertimin-e-nje-komuniteti-te-qendrueshem/>



KMSH-ja ka bashkëpunuar edhe me BE-në dhe OSBE-në, kryesisht në nisma për ndërtimin e kapaciteteve³³. Kjo përfshin edhe trajnimin e zyrtarëve të KMSH-së lidhur me temën e DERPT, ofrimin e moduleve të nevojshëm të trajnimit apo materiale të tjera për t'u angazhuar në P/LKEDH dhe aktivitete me bazë komunitare, dhe përfshirjen e KMSH-së në takime dhe mbledhje pune koordinimi³⁴. Sipas Myftiut të Tiranës, Ylli Gurra, fondet e jashtme janë të monitoruara më mirë për të parandaluar problematika siç ishte çështja e xhamive të pakontrolluara³⁵. Përfshirja në një xhami, sot, të gjitha operojnë nën juridiksionin e KMSH-së, ndërsa është rritur komunikimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të mbajtura në ambientet e këtyre xhamive. Megjithatë, mbetet e vështirë për të ushtruar mbikëqyrje dhe kontroll mbi mbledhjet e mundshme që mbahen jashtë xhamive apo në “Musalla” jo-zyrtare dhe shtëpi private³⁶.

Shkaqet rrënjësore të EDh (Islamik)

Kërkuesit që merren me ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri cilësojnë se largimi i papritur i shqiptarëve drejt Sirisë dhe Irakut është nxitur nga bashkëveprimi i disa faktorëve. Këta faktorë zakonisht ndahen në faktorë socio-ekonomikë, strukturor e politikë, si dhe ideologjikë e kulturorë^{37,38,39,40}. Faktorët socio-ekonomikë nënkuptojnë elementë të përjetuar si perceptimi i përjashtimit shoqëror, marginalizimi, mosplotësimi i nevojave sociale dhe ekonomike, varfëria, roli mundësues i rrjeteve sociale dhe dinamikat në grup. Faktorët politikë dhe strukturorë kanë të bëjnë me lidhjen mes individit dhe shtetit. Ato përfshijnë perceptimin mbi keqeverisjen, korrupsionin endemik dhe mosndëshkueshmëria e elitave, institucione joefikase, zona të qeverisura keq, si dhe mohimi i të drejtave politike dhe lirive. Nxitësit kulturorë dhe specifikë për Shqipërinë (sipas Vurmo & Sulstarova) apo faktorëve ideologjikë (sipas: Qirjazi & Shehu) përqendrohen në mënyrë të veçantë në aspektet fetare të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Këta faktorë përfshijnë mungesën e arsimit fetar të klerikëve dhe besimtarëve; vënia

³³ Intervistë me zyrtar të KMSH-së, 11 Nëntor 2020.

³⁴ *Ibid.*

³⁵ Qirjazi, R. & Shehu, R. (2018). Perspektiva e Komunitetit mbi Ekstremizmin e Dhunshëm. faqe. 20. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë: Albania

³⁶ Vurmo, G. (2018). Forumi i Kërkimit të Ekstremizmit në Ballkanin Perëndimor. British Council. Shkëputur nga: <https://www.britishcouncil.al/sites/default/files/erf20albania20report202018.pdf>

³⁷ Vurmo, G., Lamallari, B., Aleka, P. & Dhëmbo, E. (2015). Radikalizimi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri. Shkëputur nga: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>

³⁸ Bogdani, A. (2016). Shqipëri Përballet me Kërcënimin e “Luftëtarëve Xhihadist në Dritëhije: Xhihadistët Ballkanik, Radikalizimi dhe Rekrutimi i Luftëtarëve në Siri dhe Irak. Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative.. Shkëputur nga: <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2016/04/balkan-jihadists.pdf>

³⁹ Vurmo, G. & Sulstarova, E. (2018). Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri: Një Vlerësim Kombëtar i Shkaqeve, Llojeve dhe Kërcënimeve. Tiranë: Albania

⁴⁰ Qirjazi, R. & Shehu, R. (2018). Perspektiva e Komunitetit mbi Ekstremizmin e Dhunshëm. faqe. 20. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë: Albania



në diskutim e autoriteteve fetare; mosangazhimi dhe mungesa e vlerave civile; axhendat proaktive fetare; keqinformimi fetar nga grupe me qëllime të këqija; kërcënimet e gjëra kulturore; si dhe radikalizimi online.

Format e tjera të Ekstremizmit të Dhunshëm

Megjithëse ekstremizmi Islamik është manifestuar si forma kryesore e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri gjatë tre dekadave të fundit, ai nuk është forma e vetme e ekstremizmit të dhunshëm që kërkon vëmendjen e P/LKEDH dhe të angazhuarve kundër terrorizmit. Studiuesit ngrenë shqetësimin se me vazhdimin e klimës politike të tensionuar dhe shumë prej faktorëve që nxisin ekstremizmin e dhunshëm aktiv, ka mundësi të mëdha për dhunë jo-fetare në Shqipëri⁴¹. Vazhdimësia e problematikave si papunësia e lartë, përhapja e korrupsionit, pandëshkueshmëria, dhe trajtimi jo i drejtë nga qeveria dhe gjykatat mund të shërbejnë si terren pjellor për sukses të narrativave si anti-establishment⁴², populistët dhe politika të tjera ekstremiste, rrethana të cilat vetëm se mund të përkeqësohen si rezultat i ndikimit të pandemisë Covid-19 ndaj ekonomisë së vendit dhe qeverisjes (jo)demokratike⁴³.

Përveç kësaj, ekstremizmi i të djathtës ekstreme është në rritje si në Europë ashtu edhe në rajon, e cila, në varësi nga shoqëria në të cilën manifestohet, mund të ketë tendenca nacionaliste, etnike, fetare, apo thjeshtë anti-myslimane. Shqipëria konsiderohet si një ndër vendet më pak të ndikuara nga ekstremizmi i të djathtës ekstreme⁴⁴, pavarësisht disa incidenteve të shënuara gjatë viteve të fundit në Shqipëri. Si shembull i tillë, janë edhe sulmet e kryera nga shqiptari me etni greke, Kostandinos Kafica në vitin 2018, i dyshuar si anëtar i forcave paramilitare të Agimit të Artë që synon të aneksojë pjesën më jugore të Shqipërisë Greqisë⁴⁵. Apo videot e postuara në vitin 2019 nga dy shqiptarë katolikë të cilët nxisin të tjerët të sulmojnë shqiptarët myslimanë nga Kosova dhe Maqedonia të cilët vizitojnë bregdetin Shqiptar⁴⁶. Këto incidente kanë motive dhe narrativa të ndryshme, si dhe kryhen nga njerëz me prejardhje të ndryshme, gjë që rrit bindjen

⁴¹ Vrugtman, L. (2019). Sfidat e Ardhshme të Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. Shkëputur nga: <https://idmalbania.org/future-challenges-of-violent-extremism-in-the-western-balkans-february-2019/>

⁴² Vurmo, G. & Sulstarova, E. (2018). Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri: Një Vlerësim Kombëtar i Shkaqeve, Llojeve dhe Kërcënimeve. Tiranë: Albania

⁴³ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020.

⁴⁴ Rrustemi, A. (2020). Prirjet e Ekstremizmit të Djathtë në Europën Jug-Lindore: Ndikimi i Rusisë, Kroacisë, Serbisë dhe Shqipërisë. Shkëputur nga: <https://hcss.nl/sites/default/files/files/reports/Far-Right%20Trends%20Report%20Final.pdf>

⁴⁵ Associated Press. (2018). Qindra pjesëmarrës në funeralin e personit të vrarë gjatë Shkëmbimit të zjarrit në Shqipëri. Shkëputur nga:

<https://apnews.com/article/54b272ee335148d7bc6ef70e1415cc79>

⁴⁶ Lapsi.al. (2019). "Do ta mbani kryqin në ballë " / Zbardhen videot: radikalët fetar fyejnë besimtarët myslimanë. Shkëputur nga: <https://lapsi.al/2019/08/14/kryqin-ne-balle-do-mbani-zbardhen-videot-radikalet-fetare-fyejne-besimtaret-myslimane/>



se nuk ka mbështetje të përhapur të ideologjive të së djathtës radikale, dhe një organizim të përqendruar për ekstremin e djathtë në Shqipëri. Megjithatë, Qendra CVE vëren se bazuar në dhënat e marra nga burime të ndryshme, përfshi edhe nga raporte kërkimi mbi DERPT si dhe ekspertë të fushës, se ka shenja të prezencës së ekstremizmit të dhunshëm jo-fetar në Shqipëri, ku përfshihet edhe ekstremizmi me motive etnike⁴⁷.

⁴⁷ Intervistë me ekspert të Arsimit dhe Kërkimit pranë Qendrës CVE, 5 nëntor 2020.



Anti-Terrorizmi dhe Strategjitë P/LKEDH në Shqipërisë

Për të kuptuar anti-terrorin dhe prioritetet e P/LKEDH-së në vend, është me rëndësi të pranohet se qytetarët shqiptarë nuk shkuan në Siri dhe Irak vetëm si rezultat i faktorëve nxitës strukturor, socio-ekonomik dhe ideologjik, por edhe si mundësi për ta bërë diçka të tillë, pa frikë se mund të përballën me pasoja⁴⁸. Përpara gushtit të vitit 2014, ligjet shqiptare nuk pengonin qytetarët e vendit që t'i bashkoheshin një konflikti të huaj. Kur qytetarët e parë u larguan në drejtim të Sirisë në vitin 2012, ata nuk ishin të shqetësuar për pasojat e mundshme⁴⁹. Kështu, aksionet e para anti-terror dhe P/LKEDH u përqendruan në aspektin e sigurisë, me referencë ndaj sigurisë kombëtare dhe rajonale.

Anti-Terrori në Shqipëri pas vitit 2011

Për të parandaluar udhëtimin e luftëtarëve të huaj terrorist, qeveria shqiptare ka bërë disa ndryshime të Kodin Penal në vitin 2014. Shqipëria ishte një ndër vendet e para që i është përgjigjur përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar ISIS duke marrë masa konkrete legislative, administrative dhe të sigurisë⁵⁰. Për shembull, Kodit Penal i janë shtuar tre nene, neni 265/a-c mbi përfshirjen, organizimin dhe pjesëmarrjen, si dhe thirrjen për përfshirje në operacione të dhunshme ushtarake në një shtet të huaj⁵¹. Shqipëria ka bashkë-sponsorizuar Rezolutën 2178 të Këshillit të Sigurimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Përsa i përket financimit të terrorizmit dhe formave të tjera të strategjisë kundër terrorizmit, Kodi Penal kishte disa dispozita ligjore që mbulojnë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit si rrjedhojë e OSHC-ve Islamike të lidhura me grupe terroriste që operonin në Shqipëri gjatë viteve 1990⁵². Gjithsesi, edhe pse BE-ja i kishte cilësuar masat kundër (financimit të) terrorizmit në Shqipëri si prioritet i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në vitin 2009 dhe progres raportet e mëvonshme, Shqipëria nuk ka miratuar një strategji kundër terrorizmit deri në vitin 2011-të⁵³.

⁴⁸ Intervistë me ekspert të Arsimit dhe Kërkimit pranë Qendrës CVE, 5 Nëntor 2020.

⁴⁹ Qirjazi, R. & Shehu, R. (2018). Perspektiva e Komunitetit mbi Ekstremizmin e Dhunshëm. faqe. 21. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Tiranë: Albania

⁵⁰ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. (2015). Decision no. 930, Albanian National Strategy Countering Violent Extremism. Shkëputur nga: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>

⁵¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 132, Date. 19/08/2014

⁵² Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë. (2016). RAPORT: Hapat e Shqipërisë Kundër Terrorizmit. Shkëputur nga: <https://www.ZRB.int/swp/docs/3/report-albanias-anti-terrorism-steps>

⁵³ Kamolli, M. & Dyrmishi, A. (2018). Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për të Parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kornizën Ligjore të BE-së. Shkëputur nga: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albanias-Approach-to-Countering-Violent-Extremism.pdf>



Në atë vit, Këshilli i Ministrave miratoi një Strategji Ndërsektoriale kundër Terrorizmit dhe Plan Veprimin (2011-2015) dhe dy vite më vonë një Strategji Ndërsektoriale për Luftën Kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit (2013-2020). Sot, Shqipëria është palë e të gjitha konventave kundër terrorizmit të miratuara nga Këshilli i Evropës, përfshi edhe bllokimin dhe konfiskimin e të gjitha të ardhurave të siguruara nga krimi dhe financimi i terrorizmit⁵⁴. Për më tepër, Drejtoria Kundër Terrorizmit është themeluar nga Ministria e Brendshme në nëntor të vitit 2014, e cila operon brenda strukturave të Policisë së Shtetit⁵⁵. Kjo strukturë e re ka zëvendësuar Sektorin Kundër Terrorizmit, ish pjesë e Drejtorisë për Krime të Rënda dhe Departamentit të Hetimit të Krimin⁵⁶, e cila lejon personelin e Policisë së Shtetit për rendin publik të përfshihet në parandalimin e radikalizimit dhe në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm⁵⁷.

P/LKEDH në Shqipëri

Pas ndryshimeve ligjore dhe miratimit të kornizës ligjore për të luftuar kërcënimin e terrorizmit, qeveria shqiptare ka zhvendosur vëmendjen e saj drejt P/LKEDH-së. Në 2015-ën, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm bazuar në nisma të ndryshme të financuara nga SHBA-të, siç është studimi i kryer nga IDM-ja mbi radikalizimin fetar në Shqipëri dhe Samitin e 2015-ës në Shtëpinë e Bardhë⁵⁸. Plani i Veprimit që shoqëron strategjinë përfshin një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara të ndërmerren nga një grup i gjerë palësh interesi përfshi qeverinë dhe elemente nga sektori publik të përfshirë në arsim, sundimin e ligjit dhe mirëqenien sociale⁵⁹. Kjo është një qasje gjithëpërfshirëse me elementë nga e gjithë shoqëria, e cila përqendrohet në përmirësimin e kohezionit shoqëror, kundërshtimin e radikalizimit konjitiv dhe përmirësimin e qeverisjes. Plani Kombëtar i Veprimit, i cili bashkëshoqëron strategjinë, ofron shembuj të angazhimit efektiv në kuadër të LKEDH-së, me qëllim përforcimin e koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit mes palëve të interesit. Plani nxit hulumtimet në vend për të rritur njohuritë mbi DERPT dhe nivelin e qëndrueshmërisë në komunitet. Plani synon të fuqizojë qëndrueshmërinë komunitare dhe të zvogëlojë hapësirat

⁵⁴ Komisioni Evropian. (2018). Progres Raporti i Shqipërisë. Faqe. 36. Shkëputur nga:

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

⁵⁵ Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë. (2016). REPORT: Albania's Anti-Terrorism Steps. Shkëputur nga:

<https://www.ZRB.int/swp/docs/3/report-albanias-anti-terrorism-steps>

⁵⁶ *Ibid.*

⁵⁷ Komisioni Evropian. (2016). Progres Raporti për Shqipërinë 2016. Shkëputur nga:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

⁵⁸ Studimi "Radikalizimi Fetar dhe Eksremizmi i Dhunshëm në Shqipëri" nga Vurmo et al. (2015) është zhvilluar nga IDM-ja në vitet 2014-2015 me mbështjen financiare të SHBA-ve. Intervista me Qëndren CVE më 5 nëntor 2020 konfirmoj që drafti i strategjisë është frymëzuar nga SHBA-të..

⁵⁹ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. (2015). Vendimi Nr. 930, Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Shkëputur nga: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>



mundësuese nëpërmjet arsimit të përshtatur me bazë komunitare, duke krijuar mundësi punësimi, dhe programe policimi në komunitet. Së fundmi, plani synon të ulë ndikimin e propagandës së ekstremizmit të dhunshëm dhe rekrutimit online duke përdorur rrjetet sociale për të hartuar dhe shpërndarë mesazhe pozitive alternative⁶⁰.

Hartimi i strategjisë ishte një hap i parë i rëndësishëm, por për të koordinuar dhe angazhuar të gjithë palët e interesit të përfshirë në P/LKEDH, u emërua një “Kordinator Kombëtar për LKEDH-në” në korrik të vitit 2016. Një vit më vonë, në 2017, Qendra për Koordinimin Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm – në Shqipëri (CVE Centre) është themeluar si një nyje koordinimi dhe ndërtimi kapacitetesh për palët e interesit në vend dhe profesionistëve të përfshirë në vijën e parë të përpjekjeve për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri⁶¹. Ndryshe nga vendet e tjera, Koordinator dhe më vonë Qendra nuk janë vendosur në varësi të një ministrie të caktuar, por direkt nën mbikëqyrjen e Zyrës së Kryeministrit. Kjo qasje i ka dhënë shumë ndikim gjatë themelimit dhe nisjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit⁶². Megjithatë, një zyrtar i BE-së ngre shqetësimin mbi fuqizimin e Qendrës. Ky person vëren se Qendra mund të mos ketë autoritetin e duhur për të nxitur zbatimin e planit të veprimit nga institucionet e tjera. Gjithashtu, vërehet një mungesë e specifikuar në buxhetin e shtetit për një koordinim efikas të planit të veprimit, bashkë me mungesën e vullnetit për të shkëmbyer të dhëna me Qendrën⁶³. Sipas Qendrës së CVE, zbatimi është ngadalësuar nga mungesa e buxhetit. Kjo është edhe një nga arsyt kryesore përse nga gjashtë institucionet kryesore të ngarkuara me zbatimin e pjesëshëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, tre prej tyre kanë ngecur mbrapa⁶⁴.

Zbatimi i Strategjisë LKEDH: angazhimi i OSHC-ve në P/LKEDH

Megjithëse Strategjia LKEDH e Shqipërisë është e përshtatshme dhe e plotë, implementimi i planit të veprimit është i kushtueshëm dhe kërkon angazhim të fortë nga qeveria. Fatkeqësisht, kapacitetet e qeverisë janë të pamjaftueshme për të zbatuar siç duhet gamën e gjerë të aksioneve të nevojshme për një parandalim efikas të DERPT. Për të mbyllur këtë, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) – me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë – kanë zbatuar pjesën dërrmuese të nismave të planifikuara në planin e veprimit. Donatorët kryesorë janë Ambasada e Shteteve të

⁶⁰ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. (2015). Vendimi Nr. 930, Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Shkëputur nga: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>

⁶¹ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. (2017). Decision no. 737, On the Establishment of the Coordination Centre Against Violent Extremism. Shkëputur nga: https://qbz.gov.al/share/3hTBhvXdRmW_KVENDUMZ1Q

⁶² Intervistë me ekspert të Arsimit dhe Kërkimit pranë Qëndres CVE, 5 Nëntor 2020.

⁶³ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020.

⁶⁴ Intervistë me ekspert të Arsimit dhe Kërkimit pranë Qëndres CVE, 5 Nëntor 2020.



Bashkuara, BE, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, OSBE, si dhe ambasadat e tjera si Gjermane, Austriake, Suedeze, PNUD, USAID, ONM, Fondacioni Shoqëria e Hapur, Fondacioni Berghof, dhe Friedrich-Ebert-Stiftung.

Shumë shpejt pas largimit të qytetarëve shqiptarë drejt Irakut dhe Sirisë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim ka kryer një studim fillestar, i cili është mbështetur nga Ambasada e SHBA në Tiranë, për të kuptuar më mirë faktorët nxitës dhe shkaqet rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, për të krijuar një ide të qartë të nivelit të mbështetjes ndaj grupeve të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për të eksploruar cilat zona gjeografike janë më të ndikuarat⁶⁵. Që nga viti 2016, mundësitë e financimit për projekte të lidhura me P/LKEDH kanë qenë të shumta. Kjo ka shërbyer si shtysë për shumë OSHC shqiptare për t'u angazhuar në këtë fushë, pavarësisht se një pjesë e madhe e tyre kishin përvojë të pakët me fenomenin. Në vitin 2018, në kulmin e fazës zbatuese të projekteve P/LKEDH, pjesa më e madhe e OSHC-ve shqiptare ishin të angazhuara në zbatimin e së paku një projekti të lidhur me parandalimin e DERPT, disa prej të cilave janë organizata me bazë në Tiranë, dhe pjesa tjetër janë organizata me bazë vendore në nivel lokal. Fillimisht, projektet janë përqendruar në rritjen e ndërgjegjësimit mbi fenomenin. Më vonë, filluan projekte me fokus më të gjerë të çështjeve si promovimi i edukimit qytetar, dialogut ndërfetar, tolerancës fetare, dhe qëndrueshmërisë në komunitet. Këto projekte përshtaten më shumë me kategorinë e “kohezionit social”, “qeverisjes së mirë” dhe “radikalizimit konjitiv” si kategori të ekstremizmit të dhunshëm të shpalosura nga PREVEX. Ato përfshijnë rritjen e mekanizmave me bazë në komunitet për të shprehur shqetësimet; krijimin e mundësive për punësim; promovimin e qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies; përmirësimin e sektorit të drejtësisë; promovimin e zërave të moderuar të Islamit; eliminimin propagandës për ekstremizëm të dhunshëm online; si dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes.

Disa organizata si IDM, USAID, PNUD, UNICEF dhe BE janë duke zbatuar projekte që lidhen me edukimin qytetar në shkolla fillore dhe të mesme në Shqipëri, me synim nxitjen e angazhimit politik dhe shoqëror të të rinjve. Projekte të tjera, disa prej të cilave janë duke u zbatuar në shkolla, dhe të tjera që janë duke u zbatuar më gjerësisht në komunitet, fokusohen në nxitjen e dialogut fetar dhe rritjen e tolerancës fetare. Njëkohësisht, Instituti Shqiptar i Medias, Rrjeti Ballkanik për Raportimin Investigativ (BIRN), Qendra e Tiranës për Ekselencë në Gazetari dhe Qendra e UET janë duke zbatuar projekte që rrisin kapacitetet e medias në nivel lokal dhe qendror, promovojnë gazetarinë reflektuese, dhe forcojnë raportimin etik të lajmeve. Këto projekte kontribuojnë për një raportim më të balancuar mbi komunitetet fetare, nxisin

⁶⁵ Vurmo, G., Lamallari, B., Aleka, P. & Dhëmbo, E. (2015). Radikalizimi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri. Shkëputur nga: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>



gazetarinë investigative, dhe parandalojnë mundësinë që media të kontribuojë ndaj objektivave terroriste nëpërmjet “Propagandës së veprës”⁶⁶.

Në nivel vendor, bashkitë, me ndihmën e OSBE, janë duke themeluar organe si Këshilli Vendor për Sigurinë Publike (LPSC) të cilat rrisin bashkëpunimin mes aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror për të trajtuar shkaqet rrënjësore të ekstremizmit të dhunshëm⁶⁷. LPSC është ngarkuar me rritjen e ndërgjegjësimit mbi radikalizimin, rritjen e sigurisë në komunitet, dhe identifikimin e rreziqeve që paraqet ekstremizmi i dhunshëm, të cilat konsiderohen të rëndësishme për mekanizmat vendore të referimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm⁶⁸. Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje për t’i përgatitur që të përballojnë rikthimin e tyre të mundshëm nga Siria⁶⁹.

⁶⁶ Për më shumë mbi propagandën e veprës, shih librin e Nevill Bolt “Imazhi i Dhunshëm: Propaganda e Kryengritjes dhe Revolucionarëve të Rinjë” ose artikullin e Charlie Winter “ISIS po përdor median kundër vetës”.

⁶⁷ Hide, E. & Llubani, M. (2017). Roli i Shoqërisë Civile Shqiptare në Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Faqe. 24. Shkëputur nga: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14923.pdf>

⁶⁸ *Ibid.*

⁶⁹ Komisioni Evropian. (2020). Progres Raporti për Shqipërinë 2020. Faqe. 45. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf



Strategjia P/LKEDH e BE-së në Shqipëri

Që nga viti 2018, strategjia e përgjithshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor, e cila parashtron “Një perspektivë të besueshme zgjerimi për një përmirësim të angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor” ka ndikuar mbi të gjithë ndërveprimin e saj me rajonin⁷⁰. Kjo strategji vë theksin në nevojën për reforma thelbësore në disa fusha të qeverisjes, përfshi sundimin e ligjit dhe zhvillimin socio-ekonomik, sigurinë, migracionin si dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, si parakushte për të ecur përpara me procesin e integritetit⁷¹. Kjo strategji, krahasuar me strategjitë e mëhershme të BE-së në Ballkanin Perëndimor, vendos theksin në luftën kundër terrorizmit dhe P/LKEDH. Kjo pasqyron vullnetin e rritur politik në atë kohë, për të luftuar ekstremizmin në Ballkanin Perëndimor dhe në BE. Për vendet e Ballkanit Perëndimor, përmbushja e kushteve të lidhura me P/LKEDH ofron një mundësi për të shënuar pikë karshi BE-së dhe mundësisht mund të shërbejë që të zbusë kërkesat në çështje të tjera, përfshi edhe krimin e organizuar – një temë që pjesa më e madhe e zyrtarëve nuk do donin ta trajtonin⁷². Për BE-në, disa zhvillime si sulmet në Francë dhe Gjermani të kryera mes viteve 2015 dhe 2017, si dhe perspektiva e rikthimit të tyre në vendlindje ka krijuar nevojën për rritjen e kontrollit ndaj fqinjëve në rajon⁷³. BE-ja e pranon që ekstremizmi i dhunshëm nuk është një çështje urgjente siç është për disa vende në rajon apo edhe për disa vende anëtare⁷⁴. Gjithashtu, krahasuar me çështjet e tjera me të cilat përballlet vendi, siç është sundimi i ligjit, demokratizimi dhe transparencja, ekstremizmi i dhunshëm mund të mos përbëjë prioritet⁷⁵. Megjithatë, siguria dhe P/LKEDH është shumë e rëndësishme për unionin, sepse stabiliteti dhe siguria në vendet fqinje kontribuon në stabilitetin dhe sigurinë e vetë Bashkimit Evropian dhe kufijve të saj⁷⁶.

Për të rritur bashkëpunimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, BE-ja dhe qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar Planin e Përbashkët të Veprimit në luftën Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor 2018-2020⁷⁷. Ky aksion i përbashkët çon edhe më

⁷⁰ Komisioni Evropian. (2018). Një perspektivë e besueshme për rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

⁷¹ Komisioni Evropian. (2018). Strategjia për Ballkanin Perëndimor. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/commission/news/strategy-western-balkans-2018-feb-06_en

⁷² Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

⁷³ *Ibid.*

⁷⁴ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020.

⁷⁵ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

⁷⁶ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020, Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

⁷⁷ Komisioni Evropian. (2018). Nënshkrimi i Planit të Përbashkët të Veprimit mbi Luftën Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/home-affairs/news/signature-joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans_en



tej rezultatet e arrira nga vizitat e nivelit të lartë ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në luftën kundër terrorizmit (të ashtu-quajtura si Dialog KT), i mbajtur në vitin 2017-2018, në të cilin Shqipëria përfaqësohej nga Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, agjencitë e inteligjencës, OSHC-të, si dhe Qendra CVE⁷⁸. Plani i Veprimit përcakton hapa konkretë për përmirësimin e bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin e radikalizimit për të gjithë rajonin, me synim ofrimin e një fokusi të përbashkët për të zgjidhur sifdat egzistuese të sigurisë⁷⁹. Objektivat kryesore të planit janë, ndërtimi i një kornize të fortë ligjore për KT dhe P/LKEDH (përfshi kuadrin institucional dhe përafrimin ligjor, zbatimin dhe kapacitetet zbatuese); P/LKEDH efektive; shkëmbim efikas të të dhënave dhe bashkëpunim operacional; për të ndërtuar kapacitete për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; si dhe për të forcuar mbrojtjen ndaj qytetarëve dhe infrastrukturës⁸⁰.

Për më tepër, BE-ja po shqyrton shtrirjen e Rrjetit të Ndërgjegjësimit ndaj Radikalizimit (RNR) për të përfshirë Ballkanin Perëndimor, i cili efektivisht integron profesionistët nga rajoni në rrjetin me bazë në BE, ku bëjnë pjesë rreth 6000 akademikë dhe ligjvënës të angazhuar me P/LKEDH, gjë që do rrisë mundësitë për shkëmbime edhe mes vetë praktikuesve nga rajoni⁸¹. RNR organizon grupe pune tematike për praktikuesit e linjës së parë të veprimit; harton publikime mbi DERPT, mbi statusin e ekstremizmit të dhunshëm, mësimet e marra; dhe kontribuon në hartimin e politikave të BE-së lidhur me luftën kundër terrorizmit dhe P/LKEDH⁸².

Marrëveshja dypalëshe Kundër Terrorizmit

Përtej prioriteteve të përgjithshme të përcaktuara në planin e përbashkët rajonal të veprimit, është hartuar edhe një marrëveshje kundër terrorizmit, e përshtatur për nevojat specifike, prioritet e veprimit për secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor⁸³. Marrëveshja kundër terrorizmit bazohet në një "Dialog KT" të dytë, i cili është më teknik, dhe në konsultime të zgjeruara me palët kryesore shqiptare të interesit në P/LKEDH – prej të cilave Qendra CVE është pika kryesore për BE-në⁸⁴. Palë të tjera të rëndësishme vendore janë edhe Ministria e Brendshme,

⁷⁸ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020.

⁷⁹ Komisioni Evropian. (2018). Nënshkrimi i Planit të Përbashkët të Veprimit mbi Luftën Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/news/docs/20181005_joint-action-plan-counter-terrorism-western-balkans.pdf

⁸⁰ *Ibid.*

⁸¹ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020; Intervistë me zyrtar të BE-së, 9 Nëntor 2020.

⁸² Zyra e BE-së për Migracionin dhe Punët e Brendshme. (2020). Rreth RNR. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran_en

⁸³ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020.

⁸⁴ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020. Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.



Drejtoria Anti-Terror pranë Policisë së Shtetit, si dhe Ministria e Drejtësisë⁸⁵. Shoqëria civile, sipas BE-së, është jetike për zbatimin e shumë prej aksioneve, si dhe mundëson ngritjen e çështjeve të cilat qeveria nuk arrin t'i zgjidhë, si dhe drejton kritika ndaj autoriteteve kur ato nuk arrijnë të japin rezultate⁸⁶. Për Shqipërinë, zbatimi i këtyre tre objektivave, fillimisht të parashikuara për periudhën 2018-2020, mbetet primar⁸⁷.

1. Rritja e përpjekjeve në P/LKEDH, përfshi edhe trajnimin e praktikuesve vendor si dhe ndërtimin e kapaciteteve të komunikimit strategjik. Planet për adresim më të mirë të përmbajtjes terroriste online kanë marrë mbështetjen e Qendrës së Europolit Kundër Terrorizmit.
2. Ndryshimi i legjislacionit kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit terrorist sipas rekomandimeve të Moneyval⁸⁸ dhe dispozitave të Udhëzimit 4 dhe 5 Kundër Pastrimit të Parave. Gjithashtu, duhet të rriten edhe kapacitetet për hetim financiar.
3. T'i jepet zgjidhje trafikimit të armëve të zjarrit duke zbatuar Strategjinë Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksploziveve, duke bërë pjesën ndaj armëve të zjarrit si pikë qendrore.

Ndër këto tre prioritete, BE-ja i jep përparësi aksionit të parë, pasi e dyta dhe e treta janë më teknike dhe zbatohen nga autoritetet⁸⁹. Veprimet e aksionit të parë, ku cilësohet shtimi i një pike gjithëpërfshirëse mbi P/LKEDH, përfshin nisma si deradikalizimi në burgje për të burgosurit aktual nën akuza si të përfshirë në akte terroriste dhe Luftëtarët e Huaj Terrorist të Rikthyer, si dhe përforsimin e përpjekjeve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel vendor për të rritur kohezionin shoqëror⁹⁰. Në nivel lokal, duhet të rriten kapacitetet e mësuesve, zyrtarëve vendor, si dhe rritja e numrit të policëve në komunitet. Kjo ndihmon në zvogëlimin e hapësirës mundësuese për ekstremizmin e dhunshëm dhe siguron një rehabilitim dhe riintegrim efikas të LHTR-ve dhe familjeve të tyre. Për më tepër, ka nevojë të përmirësohen mekanizmat referues në nivel vendor. Organe si Këshilli Vendor për Sigurinë Publike cilësohet si një fillim i mbarë nga BE-

⁸⁵ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

⁸⁶ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 Tetor 2020.

⁸⁷ Komisioni Evropian. (2019). Komisioni dhe Autoritetet e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut mbështesin marrëveshjen dhe bashkëpunimin kundër terrorizmit. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/home-affairs/news/news/20191009_security-union-implementing-counter-terrorism-arrangements-albania-north-macedonia_en

⁸⁸ Për më shumë mbi rekomandimet, shih: "Shqipëria duhet të rrisë përpjekjet për të luftuar pastrimin e parave, shprehet raporti i Këshillit të Evropës". Shkëputur nga: <https://www.coe.int/en/web/moneyval/-/albania-should-step-up-its-efforts-to-combat-money-laundering-says-council-of-europe-report>

⁸⁹ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

⁹⁰ *Ibid.*



ja⁹¹, por kapacitet aktuale janë të pamjaftueshme dhe duhet të bëhen më pak formal ose të shoqërohen me alternativa online.

Një aksion tjetër i rëndësishëm është edhe trajnimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve në nivel vendor mbi mënyrën sesi të trajtojnë shkeljet e lidhura me terrorizmin. Si pasojë e Reformës në Drejtësi, shkeljet ligjore të kryera nga organizatat terroriste tani i referohen gjykatës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar⁹². Megjithatë, Kodi Penal e përcakton një organizatë terroriste si “Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste”⁹³. Kjo nuk përfshin të ashtuquajturit “Ujq të vetmuar” të cilët veprojnë pa ndihmën e të tjerëve, të cilët do të ndiqen penalisht në nivel qarku⁹⁴. Si BE-ja ashtu edhe OSBE-ja (kjo e fundit në bashkëpunim me Qendrën CVE) kanë plane për të rritur kapacitetet e prokurorëve dhe gjyqtarëve në nivel qarku dhe për t’iu ofruar ekspertizë shtesë⁹⁵. Së fundmi, BE-ja vëren se krahasuar me përmbajtjet në gjuhë të tjera, ato me përmbajtje radikale në shqip qëndrojnë online për periudha më të gjata kohore dhe është më gjerësisht i disponueshëm⁹⁶. Një pesë e madhe e arsyes për këtë është fakti që çështja nuk ka marrë vëmendjen e majftueshme nga autoritetet shqiptare, si dhe mungesa e kapaciteteve për t’u përballur me problemin⁹⁷. Qendra CVE e pranon që përmbajtja radikale online, dhe adresimi i prezencës së përmbajtjes në rrjet nuk ka marrë vëmendjen e duhur që nga miratimi i strategjisë për LKEDH⁹⁸. Për të rritur kapacitet e duhura për të identifikuar, monitoruar dhe fshirë përmbajtjen terroriste online, Europoli është duke bashkëpunuar me Policinë e Shtetit shqiptar⁹⁹. Sipas raportit paraprak mbi zbatimin e marrëveshjes kundër terrorizmit, është shënuar progres përse i përket këtij bashkëpunimi¹⁰⁰. Sipas Qendrës CVE, monitorimi më i mirë i përmbajtjes radikale në internet, dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi radikalizimin online janë prioritetet kryesore të cilat do të pasqyrohen në një strategji të re mbi LKEDH, kur kjo e fundit të hartohet¹⁰¹.

⁹¹ *Ibid.*

⁹² Qendra e Publikimeve Zyrtare. (2017). Neni 75/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Shkëputur nga: http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_date_30_gusht_2017_1201.pdf

⁹³ Qendra e Publikimeve Zyrtare. (2017). Neni 75/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Shkëputur nga: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf

⁹⁴ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020; Intervistë me Qendrën CVE, 5 Nëntor 2020.

⁹⁵ *Ibid.*

⁹⁶ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

⁹⁷ *Ibid.*

⁹⁸ Intervistë me Qendrën CVE, 5 Nëntor 2020.

⁹⁹ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.

¹⁰⁰ Komisioni Evropian. (2020). Progres Raporti për Shqipërinë 2020. Faqe. 45. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

¹⁰¹ Intervistë me Qendrën CVE, 5 Nëntor 2020.



Nisma të OSHC-ve të financuara nga BE-ja

OSHC-të shqiptare luajnë një rol të rëndësishëm në qeverisjen e vendit. Nisur nga mungesa e kapaciteteve të qeverisë, dhe ndonjëherë edhe nga dallimet në prioritete, OSHC-të shpesh marrin përsipër përgjegjësi të cilat kalojnë linjën e veprimit të konceptuar tradicionalisht si sferë e shoqërisë civile. OSHC-të i kërkojnë llogari qeverisë, luajnë një rol në ofrimin e shërbimit publik, si dhe zbatojnë shumë reforma dhe strategji të cilat do duhej të ishin zbatuar nga vetë qeveria. Ky është edhe rasti me strategjinë LKEDH. Të ndërgjegjshëm ndaj këtyre dinamikave, OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e strategjisë P/LKEDH të BE-së në Shqipëri.

Rritja e kapaciteteve të OSHC-ve

Për të parandaluar radikalizimin efektiv dhe në mënyrë të qëndrueshme, ka patur nevojë për të rritur kapacitetet e OSHC-ve vendore dhe palëve të tjera të interesit të përfshira në zbatimin e strategjive të P/LKEDH. Siç është theksuar në studimin “Radikalizimi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri”¹⁰², shoqëria civile në zona të thella rurale, është pothuajse inekzistente, duke lejuar që grupet radikale fetare të mbushin boshllëkun e krijuar nga mangësitë e lidhura me arsimin fetar, radikalizimin dhe çështje të tjera shoqërore. Për të adresuar problematikën, shumë donatorë të huaj kanë rritur përpjekjet për të zhvilluar kapacitetet e OSHC-ve të financuara prej tyre. Për më tepër, skemat e nëngrantimit janë krijuar për të lejuar organizatat vendore dhe OSHC-të lokale të përfshihen në projekte P/LKEDH, të rrisin kapacitetet e tyre, dhe të përmirësojnë bashkëpunimin mes OSHC-ve, dhe programe më të përshtatshme. Në Shqipëri, BE-ja është donatori kryesor i nismave për rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile, dy prej nismave më të mëdha janë aksioni i granteve për Shoqërinë Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Programit Global të STRIVE.

Aksioni i granteve për Shoqërinë Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka qenë një skemë nën grantimi e zbatuar në vitin 2017 dhe 2018, me fokus OSHC-të vendore dhe organizatat lokale për të zbatuar projekte P/LKEDH¹⁰³. Aksioni i granteve ofroi dy partneritete (një të udhëhequr nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe dy të tjera nga Terre des Hommes) me mbështetje, mjete dhe mundësi financiare për të filluar një skemë nën grantimi nga e cila kanë përfituar rreth 40 OSHC vendore me shuma deri në €10.000 për projekt¹⁰⁴. Pjesa dërrmuese e granteve të financuara nga

¹⁰² Vurmo, G., Lamallari, B., Aleka, P. & Dhëmbo, E. (2015). Radikalizimi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri. Faqe. 119. Shkëputur nga: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious-Radicalism-Albania-web-final.pdf>

¹⁰³ Shih thirrje për propozime “Shoqëria Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”. Ref Nr. EuropeAid/152207/DD/ACT/AL publikuar më 1 korrik 2017 at <https://ec.europa.eu>

¹⁰⁴ *Ibid.*



kjo skemë përqendrohet në rritjen e ndërgjegjësimit mbi radikalizimin dhe qëndrueshmërinë e komunitetit¹⁰⁵. Megjithëse skema arriti të rrisë kapacitetet e OSHC-ve vendore, projektet shpesh ishin ndërhyrje të kufizuara në kohë, dhe si të tilla, nuk ishin të qëndrueshme¹⁰⁶.

Në nivelin rajonal, BE-ja ka financuar disa projekte të lidhura me P/LKEDH, të cilat përfshijnë një komponent për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve shqiptare. Projekti 3-vjeçar rajonal Komuniteti i Pari, i menaxhuar nga Forum MNE në Malin e Zi, synon të krijojë një rrjet të shoqërisë civile për të adresuar ekstremizmin e dhunshëm¹⁰⁷. Përveç organizimit të aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit me në fokus OSHC-të, median dhe praktikues të tjerë, nisma përfshin edhe skemën e nën grantimit me €20.000 për secilin prej vendeve, për ndërhyrje afatshkurtra vendore P/LKEDH me fokus anëtarë vulnerabël të komunitetit siç janë të rinjtë dhe gratë¹⁰⁸. Partneri shqiptar i këtij projekti, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare e përqendruar kryesisht në rritjen e kapaciteteve për prokurorë dhe gjyqtarë aspirant nëpërmjet partnerit të asociuar, Shkolla e Magjistratëve në Republikën e Shqipërisë.

Një tjetër program, edhe më gjithëpërfshirës është STRIVE Global, e financuar nga BE-ja dhe e zbatuar nga Hedayah në Azinë Qendrore, Kaukazin Jugor, Turqinë, Ballkanin Perëndimor, dhe rajonin e LMAV nga viti 2015 në 2020¹⁰⁹. Ky program synon të ndërtojë kapacitetet e aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë për të parandaluar radikalizimin dhe rekrutimin për terrorizëm, duke respektuar njëkohësisht të drejtat e njeriut dhe ligjin ndërkombëtar. STRIVE në Shqipëri ka ndihmuar OSHC-të vendore të mirëpozicionuara si IDM-ja, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Institutin Shqiptar të Medias, Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza, si dhe Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë në Elbasan për të skicuar kërkime, parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, dhe projekte gazetarie¹¹⁰. Për më tepër, ofron edhe

¹⁰⁵ Për listën e plotë të projekteve fituese nga skema e dhënies së granteve nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, shih: <https://ahc.org.al/civil-society-countering-violent-extremism/>. Skema e dhënies së granteve nga Terre Des Hommes është përqendruar po ashtu në nismën, sikurse është nënvizimin e rekomandimeve në studimin bazë: https://childhub.org/en/system/tdf/library/attachments/cve_baseline_situation_analysis.pdf?file=1&type=node&id=34444

¹⁰⁶ Kamolli, M. & Dyrmishi, A. (2018). Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për të Parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kornizën Ligjore të BE-së. Shkëputur nga: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albanias-Approach-to-Countering-Violent-Extremism.pdf>

¹⁰⁷ Forum MNE. (n.d.). Komunitetet të Parat. Shkëputur nga: <http://www.forum-mne.com/en/project/communities-first/#:~:text=This%20three%2Dyear%20long%20project,effective%20and%20responsible%20social%20actors.>

¹⁰⁸ Forum MNE. (2020). Thirrje e Hapur për Projekt Propozime. <http://www.forum-mne.com/en/open-call-for-project-proposals/>

¹⁰⁹ Hedayah (Pa datë.). Programi STRIVE Global. Shkëputur nga: <https://www.hedayahcenter.org/programs/eu-strive-global/>

¹¹⁰ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.



fonde për zbatimin e projekteve si dhe korniza vlerësimi dhe monitorimi për këto projekte me qëllim rritjen e kapaciteteve zbatuese të organizatës.

Për të rritur bashkëpunimin rajonal të nismave P/LKEDH në BP, DCAF në Lubjanë në bashkëpunim me ZRB, PNUD, ONM dhe OSBE kanë lançuar një projekt me program rajonal 3-vjeçar, të financuar nga BE-ja, i cili fokusohet në rritjen e bashkëpunimit rajonal lidhur me projektet KT dhe P/LKEDH. Në saj të projektit, është krijuar një modul elektronik mësimi për praktikuesit e P/LKEDH në rajon dhe ka pritur Grupin e Mbështetjes për Qeverisjen e Integruar të Sigurisë së Brendshme (IISG)¹¹¹; një platformë për nxitjen e qëndrueshmërisë, bashkërendimit, bashkëpunimit dhe gjithëpërfshirjes së arritjeve të lidhura me P/LKEDH në Ballkanin Perëndimor¹¹². Takimet koordinuese të organizuara nga IISG mund të jenë rajonale, por ka edhe takime koordinimi për një vend specifik dhe mbledhje pune¹¹³. Në Shqipëri, si pjesë planit të veprimit të Iniciativës Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, OSBE ka organizuar një mbledhje pune lidhur me mënyrat sesi qeverisja e fortë vendore mund të ndihmojë përpjekjet e LKEDH¹¹⁴, duke ndarë përvoja me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) dhe platformat lokale të referencës¹¹⁵.

Projektet kryesore të OSHC-ve në Shqipëri

Një ndër nismat e zbatuara në Shqipëri është edhe “Shkolla si Qendër Komunitare” (SHQK) e përcaktuar në strategjinë kombëtare të LKEDH-së. SHQK nxit partneritetin mes shkollave, familjeve dhe komunitetit, duke transformuar shkollat në katalizator për kohezionin shoqëror dhe zhvillimin¹¹⁶. Deri në dhjetor të vitit 2020, Zyrtar Vendore të Arsimit kanë përzgjedhur 270 shkolla (9-vjeçare dhe të mesme) për t’u quajtur si SHQK¹¹⁷, por fatkeqësisht nuk ka burime të mjaftueshme shtetërore për të zbatuar në tërësi modelin e SHQK. Prandaj, shumë OSHC përfshi

¹¹¹ Për më shumë lidhur me modulën elektronik, shih: <https://www.dcaf-ljubljana.si/news/prevention-and-countermeasures-of-violent-extremism-p-c-674/prevention-and-countermeasures-of-violent-extremism-p-c-674>

¹¹² DCAF Ljubjanë. (2017). Mbështetje për të Parandaluar dhe Luftuar Ekstremizmin e Dhunshëm (P/LKEDH) në Ballkanin Perëndimor (IPAI2016 Multi-Country Action). Shkëputur nga: <https://www.dcaf-ljubljana.si/projects/2017/support-to-preventing-and-countermeasures-violent-extremism-629>

¹¹³ Si shembull shih mbledhjen e punës së koordinimit të organizuar nga Qendra CVE, me mbështetjen IISG/BE-së: <https://cve.gov.al/the-cve-center-gathers-donors-at-the-second-coordination-meeting-on-violent-extremism/>

¹¹⁴ Nisma e Ballkanit Perëndimor Mbi Terrorizmin. (2018). Plani i Integruar i Veprimit. 2018-2020. Shkëputur nga: <https://www.ZRB.int/swp/docs/180/wbcti--integrative-plan-of-action-2018-2020>

¹¹⁵ Presence in Albania partnered with municipalities in countering violent extremism (CVE)

¹¹⁶ Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. (2015). Strategjia Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Vendimi Nr. 930). Shkëputur nga: <https://cve.gov.al/wp-content/uploads/2018/11/strategjia-2018-me-ndryshime.pdf>

¹¹⁷ Sikurse vihet re nga Evis Kushi, Ministre e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Gjatë eventit të IDM-së për projektin Shkolla si Qendër Komunitare më 9 dhjetor 2020.



edhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Terre Des Hommes, Unë Gruaja, dhe Observatori për Fëmijë dhe të Drejtat e të Rinjve kanë zbatuar projekte të Shkollës si Qendër Komunitare me Mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar. Fondet e vogla në veçanti, si aksioni i granteve për Shoqërinë Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, të përmendur më lart, i cili ka rezultuar në disa projekte të SHQK. Megjithatë, IDM, ka ndërmarrë një qasje të modelit të SHQK që është më përfshirëse, ku përveç krijimit të një komuniteti koheziv, projekti synon të rrisë kapacitetet e studentëve të shkollës së mesme lidhur me aftësi jetike (si arsimit në të ardhmen, aftësitë e TIK, edukimin qytetar, aftësitë për të lexuar dhe dalluar materialet mediatike, si dhe ndërgjegjësimin ndaj DERPT)¹¹⁸. Ky model gjithëpërfshirës është mbështetur financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Programi i STRIVE Global, i mbështetur nga BE-ja.

Pas një projekti të mëparshëm me fokus përmirësimin e mbrojtjes së drejtave të njeriut mes të burgosurve në Shqipëri¹¹⁹, Këshilli i Evropës (KiE) ka lançuar një projekt për reformimin e burgjeve dhe luftën e radikalizimit në burgjet shqiptare. Ky projekt, i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, dhe i zbatuar nga KiE, mbështet autoritetet për të zhvilluar një plan veprimi 4-vjeçar në burgje, duke ju ofuar atyre ekspertizë për katër drafte ligjore të hartuara nga Ministria e Drejtësisë lidhur me ekzekutimin e masave kriminale, si dhe organizon një sërë aktivitete për të parandaluar radikalizimin në burgje¹²⁰. Në një temë të ngjashme, me synim ndërmjetësimin dhe deradikalizimin në burgje, OSBE-ja ka përfunduar një projekt 4-vjeçar në janar të vitit 2020. Ky projekt, i financuar nga qeveria e Austrisë, Suedisë, Gjermanisë dhe Italisë ka trajnuar stafin e burgjeve dhe të paraburgimit mbi DERPT, si dhe ka kontribuar në rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin të tyre mbi DERPT dhe ndërhyrjet me bazë të drejtat e njeriut për ti parandaluar ato¹²¹.

Të rikthyerit

Përveç trajtimit të çështjeve të brendshme, qeveria shqiptare dhe shoqëria civile përballen edhe me rikthimin e nënshtetasve shqiptar të asociuar me Shtetin Islamik. Deri në nëntor të vitit 2020, 76 nënshtetas shqiptar vazhduan të jenë në Siri¹²², prej të cilëve, përafërsisht 23 janë meshkuj,

¹¹⁸ Për më shumë rreth qasjes së IDM-së ndaj modelit “Shkolla si Qendër Komunitare”, shih: www.shkollaime.org

¹¹⁹ Këshilli i Evropës. (Pa datë.). Përmirësimi i të drejtave të njeriut në burgjet e Shqipërisë. Shkëputur nga: <https://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop/hf-albania>

¹²⁰ Këshilli i Evropës. (Pa datë.). Përmirësimi i të drejtave të njeriut në burgjet e Shqipërisë. Shkëputur nga: <https://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop/-/presentation-of-the-draft-prisons-action-plan-in-albania>

¹²¹ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. (2020). Prezenca e OSBE-së në Shqipëri prezanton rezultatet e arritura në luftën dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që paraprinë terrorizmin në burgje dhe shërbimet e paraburgimit. Shkëputur nga: <https://www.osce.org/presence-in-albania/445102>

¹²² 81 të përlllogaritur afërsisht nga Komisioni në progres raportin e vitit 2020 për Shqipërinë, minus 5 nënshtetas të riatdhesuar në tetor të vitit 2020.



19 janë femra dhe së paku 26 janë fëmijë¹²³. Ndërsa pjesa e mbetur e meshkujve shqiptar mbahen të burgosur në qendra paraburgimi përgjatë zonës Autonome të Administruar në Sirinë verilindore, ndërsa gratë dhe fëmijët jetojnë në kushte të tmerrshme në kampet e përqendrimit në al Hol dhe al Roj¹²⁴. Autoritetet shqiptare kanë synuar të rikthejnë kryesisht gratë dhe fëmijët nga kampet e Sirisë që nga viti 2019 dhe kanë miratuar një plan veprimi ndërinstytucional për rehabilitimin dhe riintegrimin (R&R) të LHT (LHTR) dhe familjeve të tyre në nëntor të vitit 2019¹²⁵. Në tetor të vitit 2020, 4 fëmijë shqiptar dhe një grua janë riatdhesuar nga al Hol¹²⁶, ndërsa është i paqartë plani kohor për rikthimin e pjesës së mbetur të qytetarëve shqiptarë. Pavarësisht se kur do të rikthehen, riintegrimi i mirëfilltë i këtyre LHTR dhe familjeve të tyre kërkon një qasje gjithëpërfshirëse nga shoqëria, ku të përfshihen institucionet qendrore dhe vendore, reaguesit e parë, komunitetet lokale, dhe vetë të rikthyerit.

Duke konsideruar që gjendja e kapaciteteve aktuale në institucione vendore dhe qendrore është e pamjaftueshme për të zbatuar në mënyrë efektive këtë strategji gjithëpërfshirëse të R&R-së, ekziston nevoja për të rritur kapacitetet e aktorëve qendror dhe vendor të qeverisë dhe për të rritur bashkëpunimin në këtë proces¹²⁷. Për më tepër që për të mbështetur në mënyrë mjaftueshme LHTR dhe familjet e tyre, duhet të rriten kapacitetet e punonjësve të linjës së parë (siç janë psikologët, sociologët, punonjësit social, mësuesit, stafit të provës dhe të burgut, si dhe stafin e zyrave të qeverisë vendore)¹²⁸. Të vendosur së bashku, këta punonjës dhe palët e interesit nga qeveria vendore, mundën që me ndihmën e OSHC-ve, të përmirësojnë ekspertizën e tyre dhe të nxisin angazhimin shoqëror, kohezionin social, dhe të ndihmojnë LHTR dhe familjet e tyre për t'u rehabilituar dhe riintegruar.

Megjithëse BE-ja nuk ka një politikë të caktuar lidhur me riatdhesimin si pasojë e dallimeve në qasje mes vendeve anëtare, ajo mbështet R&R të LHTR dhe familjeve të tyre në BP¹²⁹. Në verën e vitit 2020, Fondi i Komunitetit Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë (GCERF) njoftoi se do të mbështeste OSHC-të për të koordinuar dhe zbatuar strategjinë e R&R në Shqipëri, Kosovë,

¹²³ Sipas të dhënave të studimit “Qasja e Shqipërisë Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet, dhe Përafrimi me kornizën ligjore dhe qasjet e BE-së” nga Kamolli & Dyrmishi (2018). E disponueshme këtu:

<http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albanias-Approach-to-Countering-Violent-Extremism.pdf>

¹²⁴ Human Rights Watch. (2019). Siri: Kushtet e Tmerrshme të Familjeve të të Dyshuarve të ISIS në Siri. Shkëputur nga: <https://www.hrw.org/news/2019/07/23/syria-dire-conditions-isis-suspects-families>

¹²⁵ Komisioni Evropian. (2020). Progres Raporti i Vitit 2020. Shkëputur nga: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

¹²⁶ Euronews Albania. (2020). Nis kthimi i fëmijëve shqiptarë nga kampi “Al-Hol” në Siri. Shkëputur nga: <https://euronews.al/al/aktualitet/2020/10/26/nis-kthimi-i-femijeve-shqiptare-nga-kampi-al-hol-ne-siri>

¹²⁷ GCERF. (2020). GCERF Strategjia Rajonale për Investim në Ballkan Perëndimor. Shkëputur nga:

<https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.pdf>

¹²⁸ *Ibid.*

¹²⁹ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 Nëntor 2020.



Maqedoninë e Veriut, me një fond që shkon deri në një milion dollar amerikanë për secilin vend^{130,131}. GCERF mbështetet financiarisht nga Komisioni Evropian (DG DEVCO) dhe nga qeveritë e 15 vendeve nga e gjithë bota, përfshi, Mbretërinë e Vendeve të Ulëta, Shtet e Bashkuara të Amerikës, Japonia, Zelanda e Re, dhe Katari. Projekti i propozuar dhe konsorciumi fitues, të cilat do të përqendrohen në punën me OSHC-të dhe komunitetet e zonës, do të njoftohen në fillimi të vitit 2021¹³². Për më tepër, DG NEAR po mbështet financiarisht një program të ONM-së lidhur me të rikthyerit nga Siria, me fokus mbështetjen e autoriteteve shqiptare në rehabilitimin dhe riintegrimin (R&R) efektiv të LHTR dhe familjeve të tyre. Kjo nismë përfshin edhe hartimin e një Plan Veprimi për R&R, duke punuar me ministritë dhe institucione të ndryshme në hartimin e udhëzimeve dhe politikave që përcaktojnë përgjegjësitë përkatëse lidhur me elemente specifike të strategjisë R&R, si dhe duke përfshirë fokus të kufizuar ndaj strukturave të qeverisë lokale¹³³.

¹³⁰ The Global Community Engagement and Resilience Fund. (2020). Become a GCERF Grant Recipient in the Western Balkans. Shkëputur nga: <https://www.gcerf.org/call-for-application-westernbalkans/>

¹³¹ GCERF. (2020). GCERF Regional Strategy for Investment in the Western Balkans. Shkëputur nga: <https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2015/12/GCERF-Strategy-for-Investment-in-the-Western-Balkans.pdf>

¹³² Intervistë me zyrtar të BE-së, 9 nëntor 2020.

¹³³ *Ibid.*



Qasja e SHBA-ve për të mbështetur P/LKEDH në Shqipëri

Si pasojë e prezencës së fortë globale dhe përparimet e agjencive të saj të inteligjencës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës shpesh shihen si një aktor gjeopolitik me interes të lartë në siguri dhe përpjekjeve kundër terrorizmit. Dhe vërtetë, në Shqipëri, SHBA-të ofrojnë mbështetje bilaterale ndaj Forcave të Armatosura me trajnime, ekspertizë dhe pajisje – shpesh këto bëhen me qëllim përforcimin e pjesës jugore të NATO-s, pjesë integrale e të cilës është edhe Shqipëria¹³⁴. Megjithatë, LKEDH është shtyllë kryesore e përpjekjeve të SHBA-së kundër terrorizmit ndërkombëtar, së cilës i dedikon burime të konsiderueshme financiare dhe njerëzore. Përsa i përket mbështetjes së nismave P/LKEDH në Shqipëri, SHBA-ja njihet kryesisht për nismat me drejtim komunitar: Ambasada e SHBA-ve në Tiranë, në mënyrë specifike bën thirrje për projekt-propozime “të cilat krijojnë, zhvillojnë dhe nxisin kapaciteteve P/LKEDH dhe mënyrat që rrisin kohezionin dhe vigjilencën në komunitet”¹³⁵. Synimet primare përfshijnë ndërtimin e komuniteteve të sigurta dhe qëndrueshme; promovimi i aktivizmit rinor në P/LKEDH; përforcimin e kapaciteteve profesionale të medias lidhur me raportimin dhe promovimin e narrativave kundër ekstremizmit; si dhe riintegrimin e individëve dhe komuniteteve në rrezik për t’u radikalizuar duke iu mundësuar rifillimin e jetës dhe shansin për t’u bërë anëtar kontribuues të komunitetit ku jetojnë.

Që nga viti 2004, IDM-ja ka zbatuar projekte të mbështetura financiarisht nga SHBA-të që promovojnë dhe nxisin njohuritë shoqërore, tolerancën fetare, dhe përmirësimin e arsimit me bazë fetare për studentët e shkollave të mesme fetare. Në vitin 2015, SHBA-të financuan studimin e parë mbi radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri, i cili shërbeu për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Shqipërisë¹³⁶. Në vitin 2018 dhe 2021, dy studime të një-pas-njëshme janë kryer sërish nga IDM-ja, të cilat kanë eksploruar statusin e të gjithë llojeve të ekstremizmit të dhunshëm¹³⁷. Ambasada e SHBA-ve është gjithashtu donatori kryesor i projektit më të madh në vend, të udhëhequr nga një OSHC, projektit SHQK; dhe projektit Shkolla Ime, i zbatuar po nga IDM-ja, sikurse u përmend pak më lart.

¹³⁴ Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë. (2019). Nga fjalimi i të Ngarkuarës me Punë Moses-Ones gjatë ceremonisë së dhurimit të MRAP. Shkëputur nga: <https://al.usembassy.gov/remarks-by-charge-moses-ones-at-the-mrap-donation-ceremony/>

¹³⁵ Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë (2020). Njoftim për Mundësi Financimi. Shkëputur nga: <https://al.usembassy.gov/education-culture/grant-programs/one-time-funding-opportunities/>

¹³⁶ Të dhënat e marra nga Ambasada e SHBA në Tiranë më 5 nëntor 2020.

¹³⁷ Për studimet mbi Edh të mbështetura financiarisht nga ambasada e SHBA-së dhe të zbatuara nga IDM-ja, shih: <https://idmalbania.org/study-violent-extremism-in-albania-nëntor-2018/>



Përveç nismave të zbatuara nga IDM-ja, Ambasada Amerikane ofron një program vjetor me grante të vogla mbi P/LKEDH të cilat janë të hapura për aplikime nga OSHC-të. Ky program synon të mbështesë prioritetet e strategjisë kombëtare të Shqipërisë për shtrirje dhe angazhim në komunitet, për t'iu kundërvënë propagandës ekstremiste ndërsa promovon vlerat demokratike dhe të zhvillojë politika të LKEDH-së që janë gjithëpërfshirëse dhe afatgjata¹³⁸. Pjesa dërmuese e këtyre projekteve përqendrohen në ndërtimin e qëndrueshmërisë në komunitet; ku bëjnë pjesë disa nisma SHQK, një projekt që synon të ndërtojë një ekosistem më të sigurt kibernetik për t'iu kundërvënë radikalizimit online, një nismë për të përforcuar Këshillin Vendor për Siguri Publike, dhe aktivitete për rritjen e kapaciteteve me fokus gratë, të rinjtë, mësuesit, dhe median – që kjo e fundit të nxisë raportim reflektues dhe gazetarinë etike¹³⁹. Përfituesit e dy viteve të fundit ishin Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajza, Qendra e Tiranës për Ekselencë në Gazetari, Instituti Shqiptar i Medias, Qendra Dritare, Akademia e Studimeve Politike, Shoqata Ndërkombëtare për Solidaritet (SHIS), Qendra Shqiptare për Komunikimin Publik, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra Kombëtare Shqiptare e Burimeve për Trajnimin dhe Asistencë Teknike – ANTTARC, Shoqata “Miqte e Korçës”, Gratë për Gratë, dhe Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar në Elbasan¹⁴⁰. Si pjesë e programeve të vogla për vitin 2020, secilës prej tyre i janë alokuar fonde me madhësi nga \$30,000 deri në \$60,000¹⁴¹.

Përpjekje të tjera të ambasadës lidhur me LKEDH ndër vite përfshinë nisma që kanë kontribuar në përmirësimin e rolit dhe kapaciteteve të aktorëve vendor, veçanërisht të rinjve dhe institucioneve arsimore, për të rritur qëndrueshmërinë në komunitet dhe për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të LKEDH në nivel lokal. Në vitin 2020, KMSH-ja është mbështetur financiarisht për vitin e pestë me radhë nga Ambasada e SHBA-së në zbatimin e projekteve me fokus shtrirjen në komunitet dhe angazhimin e të rinjve¹⁴². Cikli aktual i zbatimit në Tiranë, Kukës, Lezhë, Laç, Gjirokastrë, Pogradec dhe Korçë, në fokusin e së cilës është ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme, rritja e ndërgjegjësimit mbi DERPT dhe rreziqet që paraqet. Në vitin 2016, ky projekt kishte në fokus bashkinë e Elbasanit, përfshi Cërrikun, Peqinin dhe Librazhdin¹⁴³.

¹³⁸ Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë (2020). Njoftim për Mundësi Financimi. Shkëputur nga: <https://al.usembassy.gov/education-culture/grant-programs/one-time-funding-opportunities/>

¹³⁹ Të dhëna të marra nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë më 5 nëntor 2020.

¹⁴⁰ Ibid.

¹⁴¹ Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë (2020). Njoftim për Mundësi Financimi për Projekte Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Shkëputur nga: <https://al.usembassy.gov/education-culture/grant-programs/one-time-funding-opportunities/>

¹⁴² Intervistë me zyrtar të KMSH-së, 11 nëntor 2020.

¹⁴³ Intervistë me zyrtar të KMSH-së, 11 nëntor 2020.



Krahasimi i strategjive dhe nismave të jashtme P/LKEDH

BE-ja dhe SHBA-të cilësohen si dy aktorët e huaj më të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit dhe P/LKEDH në Shqipëri¹⁴⁴. Të dy këta aktorë janë të vetëdijshëm mbi prezencën e fortë të palës tjetër në rajon dhe synojnë të krijojnë sinergji më shumë sesa të bëjnë mbivendosje me aksionet e tyre, veçanërisht pasi të dyja kanë ambicie të përbashkëta në rajon. SHBA-të kanë mbështetur gjithmonë integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik të Ballkanit, pasi një Evropë e fortë si “partneri i duhur, përfshi edhe në trajtimin e sfidave të sigurisë globale, promovimit të prosperitetit, dhe ruajtjes së normave ndërkombëtare”¹⁴⁵. Sikurse me të drejtë e nxjerrë në pah BE-ja, SHBA-të, si shtet komb, ka mundësinë të mbështesë Shqipërinë me ndihmë ushtarake dhe inteligjencë. Bashkimi Evropian, si një entitet politik i përbërë nga vendet anëtare, nuk ka as ushtri dhe as agjenci inteligjence. “Mjetet” e ndryshme në dispozicion të secilit prej këtyre aktorëve të huaj, përcaktojnë deri diku edhe ndihmën që mund t’i ofrojnë Shqipërisë¹⁴⁶. Megjithatë, vendet anëtare që kanë mundësi mund të ofrojnë ndihmë bilaterale mbi çështje që lidhen me ushtrinë dhe inteligjencën. Në një mënyrë të ngjashme, meqë vendet anëtare të BE-së nuk kanë arritur një marrëveshje për riatdhesimin e shtetasve të tyre nga Siria, blloku nuk është në gjendje t’u ofrojë ndihmë vendeve të treta me riatdhesimin e shtetasve të tyre¹⁴⁷. Prapëseprapë, nëse vendet anëtare dëshirojnë që t’i ofrojnë Shqipërisë mbështetje në rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve të saj, ato mund ta bëjnë diçka të tillë.

Përsa i përket parandalimit dhe luftimit të DERPT, si SHBA-të ashtu edhe BE-ja kanë një kuptim të fortë me bazë komunitare të P/LKEDH-së. Projektet e financuara nga programet e tyre të P/LKEDH kryesisht vendosin komunitetin si bazë dhe synojnë të rrisin qëndrueshmërinë, kohezionin social, dhe bashkëpunimin. Veçanërisht në periudhën kur P/LKEDH ishte një risi për OSHC-të, dhe mundësitë për fonde ishin të shumta, kjo krijoi mbivendosje mes mundësive për fonde mes organizatave donatore. Për gjatë katër viteve, pothuajse të gjitha mundësitë e OSHC-ve për fonde janë përqendruar në aktivitete që nxisin rritjen e ndërgjegjësimit, qëndrueshmërinë në komunitet, trajnimin e mësuesve, punonjësve të tjerë të angazhuar në linjën e parë të veprimit, si dhe në projekte të SHQK – shpesh të zbatuara edhe në të njëjtat zona gjeografike. Në shumicën e rasteve, OSHC-të e angazhuara në këtë fushë, janë të informuara mjaftueshëm për të parandaluar mbivendosje të nismave, por ndonjëherë ndodh që i njëjti komunitet të shënjestrohet nga disa projekte ose një projekt i ngjashëm zbatohet me po të njëjtin grup. Një

¹⁴⁴ Intervistë me ekspert të Arsimit dhe Kërkimit pranë Qendrës CVE, 5 nëntor 2020.

¹⁴⁵ Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. (2015). 2015 Strategjia Kombëtare e Sigurisë së SHBA-së. Shkëputur nga:

https://obamawhitehouse.archives.gov/sites/default/files/docs/2015_national_security_strategy_2.pdf

¹⁴⁶ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 nëntor 2020.

¹⁴⁷ Intervistë me zyrtar të BE-së, 26 tetor 2020



shembull i tillë ndodhi në vitin 2019, kur një shkollë u angazhua në dy projekte SHQK, të cilat zbatoheshin në të njëjtin hark kohor. Dy OSHC-të përgjegjëse arritën të bashkëpunonin dhe t'i përshtateshin nevojave, dhe si rrjedhojë arritën të zbatonin me sukses nismat, megjithatë do të ishte më mirë nëse ato do të kishin angazhuar shkolla të ndryshme. Për më tepër, rreth vitit 2017, ka patur shumë nisma në zbatim të cilat kishin në fokus zona të cilësuar si “pika të nxehta” për ekstremizmin e dhunshëm (p.sh. Cërrik dhe Peqin), ku për rrjedhojë, OSHC-të vendore vërejnë se njerëzit e angazhuar filluan të mërziten me “fjalimet mbi P/LKEDH”¹⁴⁸. Një zyrtar i KMSH-së këshilloi që përqendrimi dhe paralajmërimet e vazhdueshme mbi idetë dhe përmbajtje radikale, mund të shërbejë si nxitje për ta parë vetë – dhe të jetë shkas që ata të kërkojnë vetë për këtë material online¹⁴⁹.

Në angazhimin e tyre në Shqipëri, SHBA-të dhe BE-ja tregojnë që lënë takime për të diskutuar programe potenciale dhe të planifikuara për të parandaluar mbivendosjen e nismave¹⁵⁰. Për të rritur më tej koordinimin, BE-ja po përpiqet që të përfshijë SHBA-të në platformën IISG. Kjo platformë koordinon përpjekjet e sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke u përqendruar në tre shtylla kryesore: CT, krimin e organizuar, dhe sigurinë kufitare¹⁵¹ – prej të cilave shtylla e CT (e cila përfshin edhe P/LKEDH) është më aktivja¹⁵². Momentalisht, platforma koordinon projektet e BE-së, PNUD-it, ONM, OSBE-së, dhe DCAF Lubjanë¹⁵³. Megjithatë, në një mandat tjetër, platforma do të jetë e hapur për të gjitha palët e interesuara për t'u përfshirë, gjë që krijon potencialin që t'i bashkohen edhe SHBA-të, dhe për Britaninë pas daljes së plotë nga BE-ja, që edhe ajo t'i bashkohet platformës¹⁵⁴.

¹⁴⁸ Ky është një koment i bërë shpesh në atë kohë, që më vonë është përsëritur nga institucionet vendore si dhe KMSH-ja.

¹⁴⁹ Intervistë me KMSH-në. 11 nëntor 2020

¹⁵⁰ Intervistë me zyrtar të BE-së, 2 nëntor 2020. Intervistë me Qendrën CVE, 5 nëntor 2020.

¹⁵¹ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. (2020). Grupin e Mbështetjes për Qeverisjen e Integruar të Sigurisë së Brendshme – IISG. Shkëputur nga: https://www.ZRB.int/working_groups/50/integrative-internal-security-governance--iisg

¹⁵² Intervistë me zyrtar të BE-së, 9 nëntor 2020.

¹⁵³ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. (2020). Grupin e Mbështetjes për Qeverisjen e Integruar të Sigurisë së Brendshme – IISG. Shkëputur nga: https://www.rcc.int/working_groups/50/integrative-internal-security-governance--iisg

¹⁵⁴ *Ibid.*



Perspektiva e aktorëve vendor mbi strategjitë e huaja P/LKEDH

Institucionet, përfshi edhe Qendrën CVE, janë jashtëzakonisht pozitive rreth përfshirjes së aktorëve të huaj në P/LKEDH në Shqipëri. Duke konsideruar që komuniteti ndërkombëtar është burimi kryesor i fondeve për pjesën dërrmuese të nismave të lidhura me P/LKEDH në vend, përgjigja nuk është edhe aq e papritur. Sipas Qendrës CVE, kontributi i donatorëve të huaj si BE-ja, SHBA-atë, Britania dhe Mbretëria e Vendeve të Ulëta, janë instrumentale për Qendrën¹⁵⁵. Jo vetëm që Qendra përfiton nga mbështetja financiare që merr nga komuniteti ndërkombëtar për të zbatuar disa prej aktiviteteve të rëndësishme, por ajo përfiton edhe nga ekspertizat që sjellin donatorët e huaj. Për më tepër, Qendra vë në dukje se si pasojë e angazhimit të aktorëve të huaj, strategjia e qendrës është pasuruar nga mësimet e nxjerra nga qasjet e vendeve të tjera dhe strukturat ndërkombëtare¹⁵⁶. Një punonjës i Qendrës CVE e pranon që ndonjëherë prioritetet dhe strategjitë që vijnë nga aktorët e huaj nuk përshtaten me prioritetet e Shqipërisë, por sipas saj, Qendra ka arritur të bie dakord me donatorët dhe të sigurojë që të merren në konsideratë si prioritetet vendore ashtu edhe ato të partnerëve¹⁵⁷.

KMSH-ja gjithashtu, ka qenë shumë pozitive për të bashkëpunuar me aktorët e huaj, përfshi edhe duke marrë pjesë në takime dhe workshope të organizuara nga BE-ja ose OSBE-ja, si dhe në projekte që janë zbatuar me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-ve. Megjithatë, ata vërejnë se është e vështirë të vendoset një marrëdhënie pune afatgjatë dhe e qëndrueshme me delegacionin, kur stafi i tyre ndryshohet brenda disa vitesh¹⁵⁸. Në vitin 2016, kur KMSH-ja filloi bashkëpunimin e saj me donatorë të huaj nga perëndimi, institucioni është përballur me kritika të shumta të besimtarëve dhe imamëve. Sipas KMSH-së, disa imamë, nuk donin të bashkëpunonin me nisma të financuara nga jashtë (perëndimi), e sidomos me projekte të financuara nga SHBA-të¹⁵⁹. Në thelb, kritika ishte që SHBA-të ose BE-ja nuk janë donatorë të përshtatshëm, pasi si SHBA-ja ashtu edhe BE-ja mbështesin vetëm një grup, atë të “Gulenistëve” brenda KMSH-së. Duke konsideruar që KMSH-ja është e përçarë nisur nga interpretimet e shumta që ndjekin besimtarët shqiptarë, është parësore që mundësitë e financimeve të huaja ta bëjnë prioritet ruajtjen e besueshmërisë ndaj KMSH-së nëpërmjet hartimit të kujdesshëm të projekteve dhe pronësisë lokale.

¹⁵⁵ Intervistë me Qendrën CVE, 5 nëntor 2020.

¹⁵⁶ *Ibid.*

¹⁵⁷ *Ibid.*

¹⁵⁸ Intervistë me zyrtar të KMSH-së, 11 nëntor 2020.

¹⁵⁹ *Ibid.*



Shoqëria civile, si zbatuesi kryesor i nismave dhe aksioneve P/LKEDH të përshkruara në planin e veprimit të strategjisë, ka qenë kryesisht pozitive rreth mbështetjes nga komuniteti ndërkombëtar. Pjesa dërrmuese e OSHC-ve janë plotësisht të varura nga mbështetja e ambasadave të huaja dhe strukturave ndërkombëtare apo mbikombëtare si BE-ja, OKB-ja dhe OSBE-ja, gjë që garanton pavarësinë e këtyre organizatave nga ndikimi i qeverisë, dhe paanshmërinë e tyre në një shoqëri gjithnjë e më të politizuar. Megjithatë, përsa i përket zbatimit të nismave P/LKEDH, ka patur kritika lidhur me kufizimet e skemave të huaja të financimit. Kritika kryesore e dëgjuar ndër aktorët e shoqërisë civile është që duke plotësisht të varur nga grantet nga jashtë, në vend që të mbledhin fonde nëpërmjet donacioneve të hapura ose duke siguruar të ardhura vetë, janë donatorët ata që përcaktojnë axhendën e OSHC-ve. Kjo nënkupton që OSHC-të dhe punonjësit e tyre që angazhohen me shoqërinë civile duhet të merren me “temën e nxehtë” të momentit për të siguruar fonde, në vend që të bëhen lirshëm ekspert të një fushe të caktuar. Duke iu ofruar OSHC-ve më shumë mundësi për të zbatuar programe afatgjate me fokus ekspertizën e tyre, OSHC-të shqiptare do të mund të bëheshin më të larmishme. Për më tepër që afatet kohore të zbatimit të projekteve P/LKEDH të financuara nga BE-ja nga OSHC-të shqiptare ka variuar nga disa muaj në një vit¹⁶⁰, periudhë e cilësuar shumë e shkurtër për të adresuar DERPT në mënyrë të qëndrueshme^{161,162}. Kjo nuk ofron mundësi për organizatat e shoqërisë civile që të arrijnë rezultatet e dëshiruara, të përcaktuara në strategjinë LKEDH, si dhe nuk e bën të mundur që projekti të ketë një ndikim të qëndrueshëm në kohë.

Por akoma më e rëndësishme, është numri i lartë i organizatave të përfshira në aksione P/LKEDH me bazë komunitare, gjë që e bën të ngjajë sikur secila prej tyre po shpik rrotën nga fillimi. Një sërë organizatash zhvillojnë dhe zbatojnë nisma të ngjashme një-kohore, siç është për shembull nisma për Shkollën si Qendër Komunitare, trajnimi i punonjësve të linjës së parë në DERPT, ose nismave për ndërtimin e kapaciteteve të medias. Sa herë që skicohet një projekt, materiale të reja janë zhvilluar, staf i ri (OSHC-ve) trajnohet, dhe secila prej tyre në shërbim të një aktiviteti apo nisme të vetme, në vend që një organizatë e vetme të shpalojë një nismë me shkallë më të gjerë.

Së fundmi, lidhur me matjen e ndikimit të nismave P/LKEDH, vërehet mungesa e theksimit të nevojës për të monitoruar dhe vlerësuar strategjinë e përgjithshme të aktorëve të huaj dhe

¹⁶⁰ Duke mos konsideruar shtyrjet pa kosto të fatkeqësive natyrore.

¹⁶¹ Hide, E. & Llubani, M. (2018). Roli i Shoqërisë Civile Shqiptare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Friedrich Ebert Stiftung. Shkëputur nga: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14923.pdf>

¹⁶² Kamolli, M. & Dyrnishi, A. (2018). Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kornizën Ligjore të BE-së: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albanias-Approach-to-Countering-Violent-Extremism.pdf>



vendor. Megjithëse të gjithë projektet e financuara nga BE-ja përfshijnë monitorimin dhe vlerësimin e udhëzimeve dhe detyrimeve¹⁶³, nuk ka një metodologji gjithëpërfshirëse për të vlerësuar ndikimin e nismave të BE-së ndaj P/LKEDH në Shqipëri, apo kontributin e saj ndaj strategjisë P/LKEDH¹⁶⁴. Në të vërtetë, Qendra CVE është përgjegjëse për të vlerësuar zbatimin e plotë të strategjisë LKEDH dhe planit të veprimit¹⁶⁵. Por megjithatë, strategjia aktuale ka tashmë pesë vite që zbatohet dhe Qendra CVE akoma nuk e ka vlerësuar as strategjinë dhe as planin e veprimit¹⁶⁶. Është e vërtetë që, brenda ciklit aktual të projekteve të BE-së për periudhën 2019-2020 do të nxirren mësimet, por për të krijuar mundësitë e duhura kohore për të përshtatur në kohë nismat e financuara nga BE-ja, në mënyrë që këto të fundit të jenë sa më funksionale në rrethanat e vendit, do të ishte mirë që BE-ja të kishte një metodologji vlerësimi periodike.

¹⁶³ Intervistë me zyrtar të BE-së, 9 nëntor 2020.

¹⁶⁴ Intervistë me zyrtar të BE-së 26 tetor 2020.

¹⁶⁵ *Ibid.*

¹⁶⁶ Intervistë me Qendrën CVE, 5 nëntor 2020.



Konkluzion

Aktorët ndërkombëtarë luajnë një rol parësor në vendosjen e CT dhe P/LKEDH në axhendën e autoriteteve shqiptare. Që nga mesi i viteve 1990, ambasada e Shteteve të Bashkuara ka luajtur një rol kyç në zbatimin e masave CT dhe më vonë, në mundësimin e hartimit të strategjisë kombëtare të LKEDH dhe planin shoqëruar të veprimit. Po ashtu, edhe Bashkimi Evropian, që nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Asociim Stabilizim në vitin 2009, ka ngritur vazhdimisht çështjen e financimit të terrorizmit, si dhe nevojën për zbatimin e legjislacionit që lidhet me CT. Nisur nga mbështetja financiare e marrë nga BE-ja dhe SHBA-të, qeveria shqiptare e ka kthyer P/LKEDH në një prioritet, si dhe ka themeluar Qendrën për Koordinimin e CVE, e cila është direkt në varësi të Zyrës së Kryeministrit. Në vitin 2018, pas miratimit të strategjisë për Ballkanin Perëndimor, e cila në fokus ka integrimin evropian, blloku ka si qëllim edhe rritjen e bashkëpunimit me vendet e rajonit në luftën kundër terrorizmit. Bazuar në disa vizita të nivelit të lartë, është hartuar një Plan Veprimi i Përbashkët Kundër Terrorizmit për vendet e Ballkanit Perëndimor për vitet 2018-2020, e cila është pasuar nga një marrëveshje specifike që lidhet me CT, me secilin prej vendeve të rajonit. Prioritet e përcaktuara në marrëveshje përfshijnë, rritjen e përpjekjeve P/LKEDH në rang vendor, kundërshtimi i përmbajtjeve radikale në internet, zbatimi i masave legjislative mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe parandalimin e tregtimit të armëve të paligjshme, të cilat edhe janë zbatuar në bashkëpunim të ngushtë mes BE-së dhe Shqipërisë.

Përveç ofrimit të ekspertizës dhe mbështetjes në zbatimin e marrëveshjes CT, donatorët e huaj, përfshi BE-në, vendet anëtare, por edhe Shtetet e Bashkuara, OKB-ja, si dhe organizatat e vendeve jo-anëtare të Bashkimit Evropian, kanë luajtur një rol kyç për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që paraprijnë akte terroriste, në Shqipëri. Pa ndihmën nga jashtë për aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë që punojnë në P/LKEDH, statusi i zbatimit të Strategjisë LKEDH dhe planit shoqëruar të veprimit, në rastin më të mirë do të ishte i kufizuar. Megjithatë, edhe udhëheqja e nismave P/LKEDH nga njësi të huaja ka koston e vet. Kjo kufizon Shqipërinë që të përcaktojë vetë axhendën për zbatimin e planit të veprimit. Kjo gjithashtu pengon organizatat e shoqërisë civile që të zhvillojnë ekspertizën e tyre në fusha të caktuara si dhe përcaktimin e programeve afatgjata për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm në mënyrë efikase. Për më tepër, kur aktorët e huaj janë donatorët kryesorë të aksioneve që lidhen me P/LKEDH, kjo nuk ndihmon pronësinë lokale të aksionit, dhe në rastin më të keq, kjo mund të nxisë narrativa ekstremiste që pohojnë se autoritetet shqiptare janë të paafta apo të tjerë që argumentojnë se qeveria dhe KMSH janë agjentë të perëndimit, apo të kontrolluar prej tyre. Është gjithashtu e mundshme, që kur donatorët e huaj përkufizojnë parametrat e mundësive për fonde, që të mos përfshihen apo të merren në konsideratë të gjitha prioritetet e qytetarëve, kur hartohen projekte dhe programe specifike.



Rekomandime

1. **BE-ja duhet të marrë në konsideratë shënjestrimin e formave të tjera të ekstremizmit përveç atij Islamik, siç janë ekstremizmi i të djathtës ekstreme, ekstremizmi etnik, ose edhe dhunën politike.** Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi studiuesit dhe praktikuesit nënvizojnë që shkaktarë të dhunës ekstreme në Shqipëri nuk janë vetëm faktorët ideologjikë, por edhe ato strukturorë, social dhe ekonomikë.
2. **Është e nevojshme të përmirësohet pronësia vendore e projekteve që lidhen me P/LKEDH dhe programet e zbatuara në Shqipëri.** Një shkak i rëndësishëm që nxit ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri është edhe çështja strukturore si perceptimi mbi qeverisjen e dobët, apatia e institucioneve të sigurisë, mungesa e prezencës së një shteti të konsoliduar dhe korrupsioni. Duke mos i bërë këto institucione një pjesë integrale të zgjidhjeve, perspektiva e qytetarëve ndaj këtyre institucioneve nuk do të ndryshojë.
3. **Të çohen deri në fund zbatimi efikas i politikave, strategjive dhe aksioneve të miratuara nga institucionet qeveritare.** Shpesh, qeveritë e rajonit shohin miratimin e një ligji si mundësi vetëm për të plotësuar kërkesat e BE-së, qoftë kjo sepse BE-ja ishte një partnere donatore e nismës, apo sepse politika është në linjë me detyrimet për anëtarësim në BE. Gjithsesi, në mungesë të kërkesave lidhur me statusin e zbatimit të këtyre politikave, strategjive apo plan veprimeve, këto ligje shpesh mbetën “fjalë në letër”¹⁶⁷.
4. **Është e nevojshme që organizatat e shoqërisë civile të bëhen më të larmishme dhe më profesionale, në mënyrë që punonjësit e tyre të zhvillojnë ekspertizën e duhur në fusha të caktuara.** Kjo do të mundësonte ndërtimin e kapaciteteve afatgjata për stafin dhe bashkëpunëtorët e tyre, nga e cila mund të lindin ndërhyrje P/LKEDH më të përshtatshme, të bazuara në të dhëna konkrete.
5. **BE-ja duhet të shqyrtojë ri-financimin e nismave të përshtatshme dhe efikase, që janë zbatuar mirë, duke aplikuar të njëjtën metodologji në hapësira të tjera gjeografike, ose duke bërë fondet e disponueshme për kohë më të gjatë.** Shpesh herë, kapacitet janë ngritur, rrjeti është themeluar, materialet janë përgatitur, por të gjitha shfrytëzohen vetëm për një cikël të vetëm projekti. Duke e shtyrë apo zgjeruar një projekt të tillë, materialet dhe ekspertiza mund të ripërdoren dhe OSHC-të nuk do kishin nevojë të rishpiknin rrotën.

¹⁶⁷ Kamolli, M. & Dyrmishi, A. (2018). Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për Qasja e Shqipërisë për të Parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kornizën Ligjore të BE-së. Shkëputur nga. Faqe 21. Shkëputur nga: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2019/02/Albanias-Approach-to-Countering-Violent-Extremism.pdf>



6. **Të mbështetet Qendra CVE që të zhvillojë dhe të zbatojë një kornizë efikase për monitorimin dhe vlerësimin** për të gjitha projektet e zbatuara nga OSHC-të që operojnë në Shqipëri. Kjo do ndihmonte në matjen e ndikimit të projekteve dhe do të shërbente si udhëzues për prioritetet e donatorëve.
7. **BE-ja duhet të zhvillojë mjetet e duhura për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimin e përgjithshëm të nismave P/LKEDH të financuara nga prej saj.** Në të vërtetë, Qendra CVE është përgjegjëse për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë LKEDH dhe Planit të Veprimit. Megjithatë, këto strategji zgjasin disa vite përpara se të kryhet një vlerësim. Në mënyrë që nismat e BE-së të përshtaten në kohë me rrethanat vendore, do të ishte mirë që BE-ja të kishte një metodologji vlerësimi vjetore apo për çdo dy vite.

Kufizimet

Ky studim bazohet në ekspertizën e autores në VE dhe P/LKEDH në Shqipëri, angazhimin e gjatë të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim me P/LKEDH, rishikimi i literaturës , dhe intervista të ekspertes me zyrtarë të angazhuar me temën. Kjo metodologji është adoptuar si pasojë e vështirësisë për të kryer studime në terren gjatë pandemisë së COVID-19. Megjithëse ky studim arrin të paraqesë në mënyrë efikase statusin e ekstremizmit të dhunshëm dhe P/LKEDH në Shqipëri, si dhe strategjitë kryesore të huaja, kjo metodologji ka implikime për rezultatet dhe kornizën e përgjithshme të zbatimit të nismave P/LKEDH në Shqipëri. Kur lexon këtë raport, duket sikur BE-ja, SHBA-të dhe aktorë të tjerë të jashtëm ndihmojnë me strategji të rëndësishme qeverinë shqiptare, dhe për rrjedhojë ofrojnë ndihmë kur ka mangësi. Gjithashtu duket sikur strategjia LKEDH është duke u zbatuar në mënyrë efikase sipas nevojave dhe prioriteteve të vendit.

Me të vërtetë, donatorët e huaj kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit LKEDH në Shqipëri. Pa ndihmën e tyre, ka shumë të ngjarë që autoritetet shqiptare nuk do të kishin trajtuar P/LKEDH ashtu siç e kanë bërë. Pavarësisht se aktorët e huaj bëjnë shumë përpjekje për të përshtatur strategjitë dhe planet e veprimit të tyre me rrethanat në Shqipëri, analizat e kontekstit dhe prioritetet e identifikuara janë konsultuar kryesisht vetëm me autoritetet shqiptare dhe palë të tjera elitare. Prandaj, disa prej prioriteteve qytetare mungojnë, veçanërisht ata që jetojnë në zona ku mungojnë OSHC-të dhe udhëheqësit në komunitet, të cilat rastisin të jenë edhe zonat më të ndjeshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Së fundmi, megjithëse aktorët e huaj kanë vënë në dispozicion fonde të konsiderueshme për P/LKEDH në Shqipëri, pjesa më e madhe e tyre shkon për autoritetet dhe OSHC-të. Kjo është e kuptueshme pasi përpjekjet e tyre përfshijnë komponentë të mëdhenj për ndërtimin e kapaciteteve, ndërsa si autoritetet ashtu edhe OSHC-të kanë kosto operationale dhe njerëzore



që i përdorin për zbatimin e aksioneve, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit. Megjithatë, kjo nënkupton që vetëm një shumë e vogël e fondeve shkojnë për të përfituar personat të cilët kanë edhe nevojë më shumë se askush tjetër.



This project has received funding from the European Union's Horizon 2020 research and innovation programme under grant agreement no 870724. Unless otherwise indicated, the views expressed are attributable only to the authors in a personal capacity and not to any institution with which they are associated, nor do they necessarily reflect the views or policy of the European Commission. For more information on the PREVEX project, see <http://www.prevex-balkan-mena.eu>.